



Shoqata "Shpresë për të Ardhmen"



Kthimi nga Emigracioni dhe Sfidat e Riintegrimin

Kthimi nga Emigracioni dhe Sfidat e Riintegrit

***Analizë studimore e punës së shoqatës
“Shpresë për të Ardhmen” për periudhën
prill 1999 - qershor 2006***

*Përgatitur nga:
Sonila Danaj*

Shtator 2006



Sonila Danaj e përgatiti këtë analizë studimore në mënyrë të pavarur, por me
kërkesën e shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”.

Botues:

Shoqata “Shpresë për të Ardhmen”

Blvd. “Gjergj Fishta” Kulla 8 Ap.11 Tiranë

Tel./Fax: (04) 224 033

E-mail: shprese@shprese.org

Website: www.shprese.org

Kjo është përpjekja e parë për të analizuar një veprimtari shtatëvjeçare të një shoqate që ka punuar me përkushtim për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve të kthyer. Programi i saj i riintegrimit ka ardhur duke u pasuruar dhe projektet duke u shtuar falë ndihmës së paçmuar të donatorëve që e kanë shoqëruar dhe vlerësuar aktivitetin e saj në vite.

Shpresojmë që kjo përpjekje e parë për botime të këtij lloji të pasohet nga botime të tjera në të ardhmen.

Irena Dono

Tabela e Përmbajtjes

1. Lloji i Studimit dhe qëllimi i tij.....	9
1.1 Konteksti	
1.2 Objektivat dhe pyetjet e shtrua nga studimi	
1.3 Qëllimi i studimit	
1.4 Metodologjia	
2. Konteksti në të cilin vepron shoqata “Shpresë për të Ardhmen”	13
2.1 Hyrje	
2.2 Historiku i migracionit shqiptar	
2.3 Shkaqet e migracionit	
2.4 Kthimi në Shqipëri	
3. Politikat Migratore.....	17
3.1 Politikat e vendeve të Evropës në lidhje me kthimin e emigrantëve	
3.2 Politikat e shtetit shqiptar në lidhje me emigrantët e kthyer	
3.3 Lidhja mes institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare	
4. Qëllimi dhe misioni i shoqatës	23
4.1 Si lindi shoqata	
4.2 Misioni dhe objektivat	
4.3 Grupet Përfituese	
4.4 Metoda e punës	
4.5 Projektet e zbatuara	
4.6 Donatorët	
5. Kontributi i shoqatës në integrimin e emigrantëve të kthyer	35
5.1 Aktivitetet e shoqatës	
5.2 Grupi i të rikthyerve forcërisht.	
5.3 Grupi i të rikthyerve që kanë qenë emigrantë të parregullt ose jo.	
5.4 Grupi i migrantëve të brendshëm.	
5.5 Arritjet	
5.6 Vështirësitë, shkaqet dhe kapërcimi i tyre	
6. Përfundimet, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet.....	63
6.1 Përfundimet	
6.2 Mësimet e mësuara	
6.3 Rekomandimet	
Bibliografia	68
Shtojcat	71

1. Lloji i Studimit dhe qëllimi i tij

Duna disavjeçare e shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” në fushën e riintegritimit të emigrantëve të kthyer dhe atyre të brendshëm ishte shtysa kryesore për zhvillimin e këtij studimi, që do të mbështetet në analizën e punës së shoqatës gjatë periudhës 1999 – 2006. Ai synon të studiojë fenomenin e kthimit, veçantitë e tij në rastin e Shqipërisë, masat e ndërmarra për lehtësimin e riintegritimit, si edhe sugjerimet e rekomandimet që lindin nga vlerësimi i eksperiencës së drejtpërdrejtë të shoqatës me emigrantët e kthyer dhe migrantët e brendshëm.

1.1 Konteksti

Shoqata ka tashmë një eksperiencë 7 vjeçare në fushën e riintegritimit të emigrantëve shqiptarë të kthyer. Ajo ka zhvilluar projekte si “Kape të Ardhmen”, VARRP, “Hidhe Hapin”, etj., të cilat kanë synuar riintegrimin ekonomik dhe social të të kthyerve ose të emigrantëve të brendshëm. Gjatë kësaj periudhe aktivitetet e shoqatës kanë qenë në rritje të vazhdueshme. Ajo ka qenë e para që ka trajtuar çështjen e riintegritimit të të kthyerve me forcë dhe atyre vullnetarë në Shqipëri. Gjithashtu është nga të parat që nuk është mjaftuar me riintegrimin ekonomik, por ka organizuar aktivitete shoqërore, të cilat kanë pasur si synim edhe lehtësimin e përshtatjes sociale të të kthyerve. Në këto momente ajo është duke kaluar një fazë rritjeje dhe zgjerimi nëpërmjet marrjes përsipër të projekteve të reja, si edhe të hapjes së zyrës rajonale në Shkodër.

1.2 Qëllimi i studimit

Ky studim ka si qëllim të paraqesë një analizë të punës së shoqatës në fushën e rikthimit me fokus në procesin e riintegrit të të kthyerve. Volumi i madh i punës dhe karakteristikat e rasteve të trajtuara çuan në nevojën e një studimi, i cili do të marrë parasysh fenomenin e kthimit të emigrantëve, situatën e tyre në Shqipëri pas kthimit dhe kontributin konkret të shoqatës në lehtësimin e riintegrit të kategorive të ndryshme të migrantëve (të kthyer forcërisht, vullnetarisht si edhe migrantë të brendshëm).

1.3 Objektivat dhe pyetjet e shtruar nga studimi

Studimi ka si objektiva kryesore:

- a) nxjerrjen në pah të domosdoshmërisë së programeve të riintegrit
- b) identifikimin e kontributit konkret të shoqatës për riintegritin
- c) vlerësimin e këtij kontributi
- d) nxjerrjen e mësimave nga eksperiencia e drejtpërdrejtë e shoqatës
- e) ofrimin e rekomandimeve

Pyetjet e parashtruara për zhvillimin e këtij studimi ishin:

- a) A janë të nevojshme programet e riintegrit dhe pse?
- b) Cili ka qenë kontributi i shoqatës për riintegritin e emigrantëve të kthyer dhe atyre të brendshëm?
- c) Në ç'mënyrë dhe deri në ç'pikë kanë ndikuar projektet e ndryshme të shoqatës në lehtësimin e procesit të riintegrit të të kthyerve?
- d) Çfarë rezultatesh kanë pasur?
- e) Cilët kanë qenë faktorët që kanë ndikuar këto rezultate?
- f) Çfarë mësimesh janë nxjerrë?
- g) Çfarë rekomandimesh mund të ofrohen?

1.4 Metodologjia

Studimi është bazuar në hulumtimin e të gjithë dokumentacionit të shoqatës, raporteve gjashtëmujore dhe vjetore, anketave të zhvilluara nga ata gjatë procesit të punës së tyre dhe një grup intervistash të zhvilluara nga vetë studiuesja me punonjësit e projekteve të shoqatës, si edhe disa nga punëdhënësit që kanë bashkëpunuar me shoqatën për realizimin e riintegrit të të kthyerve.

Përveç hulumtimit të raporteve dhe bisedave me stafin e shoqatës, ky kapitull do të bazohet edhe në një grup intervistash të zhvilluara me përfitues të kategorive, moshave, seksit dhe vendeve të ndryshme nga vijnë. Janë 31 persona, nga të cilët 21 meshkuj dhe 10 femra. Ata janë zgjedhur midis

përfituesve të mëparshëm dhe të tanishëm. Të përzgjedhurit janë nga projekti kryesor i shoqatës “Kape të Ardhmen”, VARRP, “High Level Working Group”, ALNIMA dhe “Hidhe Hapin”. Ata i përkasin të trija kategorive: emigrantë të kthyer forcërisht, të kthyer vullnetarisht dhe migrantë të brendshëm dhe i përkasin grup-moshave nga 18 vjeç deri në 45 vjeç. Të intervistuarit banojnë në qytetin e Tiranës, Beratit, Shkodrës, Durrësit, Vlorës dhe në Laknas, ku shoqata po zhvillon projektin “Hidhe Hapin”.

Për më tepër, në këtë studim do të paraqiten të dhëna statistikore të mbledhura nga vetë punonjësit e shoqatës gjatë periudhës shtatëvjeçare, të cilat do të reflektojnë mbi rezultatet reale të punës së tyre dhe impaktin që kanë pasur në grupin e të kthyerve dhe në procesin e riintegrit të tyre në Shqipëri.

Pas paraqitjes statistikore të numrit të vizitorëve dhe përfituesve të shoqatës në bazë të llojit të shërbimit nga i cili kanë përfituar, do të bëjmë një analizë të punës së shoqatës me secilën nga kategoritë e të kthyerve: me forcë, vullnetarë dhe migrantë të brendshëm. Kështu, do të analizojmë punën që shoqata ka bërë me këto grupe që nga kontakti i parë në vendet pritëse, puna e tyre me Shpresë për të Ardhmen, arritjet e tyre individuale, e deri te vështirësitë dhe shkaqet e këtyre vështirësive, si edhe masat e ndërmarra nga shoqata për kapërcimin e tyre.

2. Konteksti në të cilin vepron shoqata “Shpresë për të Ardhmen”

2.1 Hyrje

Rënia e sistemit në Shqipëri u parapri nga fenomeni i emigrimit që në vitin 1990, ku me qindra njerëz u dyndën nëpër ambasadat e huaja në vend. Më pas grupe të mëdha njerëzish u larguan me anije ose në rrugë tokësore, dhe sot mendohet se rreth 710.000 qytetarë shqiptarë banojnë në emigrim (INSTAT 2004, f. 34). Gjithsesi, shifrat nuk janë të sigurta pasi nuk ka një numërim të saktë të emigrantëve shqiptarë në vendet pritëse. Arsyeja mbetet fakti se jo të gjithë emigrantët janë me status të rregullt dhe me leje qëndrimi dhe një pjesë janë rregjistruar me identitet fals, si psh Kosovar, duke qenë se në periudhën e krizës kosovare në 1998 e në vijim kërkuan azil politik në shumë vende të Evropës së Bashkuar. Ndër këto, vendet me më shumë emigrantë shqiptarë mbeten Italia dhe Greqia, por edhe vendet e tjera si Zvicra, Gjermania apo Mbretëria e Bashkuar kanë grupe të konsiderueshme shqiptarësh në territorin e tyre. Po të njëjtat vende kanë gjithashtu në territorin e tyre emigrantë shqiptarë të parregullt, të cilët kur ndalen nga autoritetet e këtyre vendeve u kërkohet të largohen dhe në raste të caktuara edhe dëbohen. Largimi i tyre sot rregullohet nëpërmjet Marrëveshjes së Ripranimit midis BE dhe Shqipërisë, si edhe marrëveshjeve dypalëshe të kësaj natyre të firmosura midis vendeve të tjera europiane si Zvicrës dhe Shqipërisë.

2.2 Historiku i migracionit shqiptar

Studiuesit numërojnë tre valë kryesore të emigrimit të shqiptarëve. Gjatë vitit 1991-1992, ndryshimet politike sollën dhe një mungesë sigurie për jetën dhe ekonomike, që i shtyu shumë shqiptarë të emigrojnë në mënyrë të paligjshme. Duke qenë vala e parë e emigrantëve që vinin nga Evropa Lindore në përgjithësi, shumica prej tyre arritën të rregullojnë statusin e tyre në vendet pritëse. Ndërkohë që, me kalimin e viteve pritej të pakësoheshin ikjet, vëmë re se deri në 1997, emigrimi nga Shqipëria drejt Evropës ka vazhduar në forma të organizuara kriminale. Largimet u intensifikuan me valën e dytë të emigrimit gjatë krizës së 1997, e cila shkaktoi një pasiguri shumë të madhe në vend, dhe rezultoi me ikje të mëdha njerëzish. E njëjta situatë u përsërit edhe në 1998, ku disa njerëz shfrytëzuan krizën e Kosovës për t'u larguar nga vendi. Kjo valë ikjesh, që sipas disa studiuesve nxori deri në 100.000 shqiptarë nga Shqipëria (shih Kule et al., 2002) është quajtur dhe vala "e padukshme", sepse këta individë janë paraqitur në vendet pritëse me identitet të rremë, kryesisht kosovar. Të treja këto valë dhe ikja e vazhdueshme e shqiptarëve kanë qenë karakterizuar nga emigrimi i ligjshëm dhe i paligjshëm, ose emigrimi i ligjshëm e qëndrimi i paligjshëm në vendet pritëse.

Fillimisht, emigrimi shqiptar ka qenë kryesisht mashkullor, por më pas është shoqëruar me fenomenin e bashkimit familjar, apo shtimin e emigrimit femëror (shih Misja 1998).

Sot emigrimi është pakësuar shumë, sidomos ai i parregullt, falë përforcimit të kufijve shqiptarë, por edhe si pasojë e firmosjes së marrëveshjeve të ripranimit midis Shqipërisë dhe disa vendeve të BE-së, që kohët e fundit u zëvendësuan nga një marrëveshje ripranimi kuadër midis Shqipërisë dhe BE¹, sipas së cilës të gjithë emigrantët shqiptarë pa leje qëndrimi të rregullt në vendet e BE-së do të kthehen në vendin e origjinës. Pra, ikja e shqiptarëve për në Perëndim është shoqëruar dhe me rikthimin e tyre në atdhe.

2.3 Shkaqet e migracionit

Arsyet e emigrimit të shqiptarëve për periudhën 1990-2006 mbeten kryesisht ato ekonomike dhe politike. Faktorët shtytës (push factors) listojnë kushtet e këqija të jetesës, varfërinë, papunësinë e madhe, mungesën e sigurisë

¹ Marrëveshje kuadër do të thotë se Shqipëria ka bërë një marrëveshje me të gjitha vendet e BE-së në grup si të ishin një vend i vetëm, në vend që të kryente marrëveshje të veçanta dypalëshe me secilën nga vendet anëtare të BE-së. Pra, Shqipëria dhe BE bien dakort për parimet dhe rregullat bazë të ripranimit të migrantëve të parregullt, ndërkohë që procedurat e zbatimit përcaktohen nga protokollet dypalëshe të zbatimit.

personale dhe të stabilitetit politik, si edhe një rend ligjor të dobët (shih de Soto et al, 2002; King and Vullnetari, 2003) . Nga ana tjetër, faktorët tërheqës (pull factors) si kurioziteti për vende të tjera, dëshira për të provuar jetesën në vende jototalitare, për një karrierë personale apo për një të ardhme më të mirë gjithashtu kanë luajtur rol që disa shqiptarë të emigrojnë ose të vendosin të rinë në vendet pritëse (shih Bajraba, 2004).

2.4 Kthimi në Shqipëri

Arsyet kryesore të rikthimit kanë qenë kthimi i detyruar nga autoritetet vendase, pasi këta janë gjetur me dokumente të parregullta ose u është mohuar qëndrimi apo rinovimi i lejes së qëndrimit në vendin e tyre. Vendet kryesore që kanë kthyer emigrantë të paligjshëm janë Zvicra, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Italia dhe Greqia. Por sot kemi edhe një valë të lehtë rikthimi vullnetar, i cili mbetet krejt i papërfillshëm përkundrejt atij të detyruar.

Pavarësisht nga përpjekjet e vendeve pritëse të firmosin marrëveshje ripranimi me Shqipërinë dhe të rikthejnë shqiptarët, shpesh ata e kanë gjetur veten të pafuqishëm kur kanë rigjetur të njëjtët njerëz në territorin e tyre pak kohë më vonë, përsëri pa lejeqëndrim të rregullt. Kjo situatë ka shtyrë plot studjues të arrijnë në përfundimin se rikthimi fizik i individëve nuk mjafton. Ndër problemet kryesore që shfaqen duke e vështirësuar rikthimin do të përmendim:

- Pagat më të ulëta apo kushtet ekonomike më të këqija se në vendin pritës;
- Marrëdhënie të vështira midis të kthyerve dhe komunitetit që s’ka qenë emigrant;
- Frustrimi me klimën e biznesit, sistemin bankar në vendin e origjinës etj;
- Shqetësimi për korrupsionin apo “mënyrën e ndryshme të të bërit të gjërave” në vendin e origjinës;
- Kursime të pakta për t’i përdorur qoftë për konsum apo prodhim, duke lënë përshtypjen se të ardhurat e migrantit “humbasin” prej zhvillimit;
- Kërkesa të tepërta për burime nga ana e familjes dhe shoqërisë së migrantit;
- Nostalgjia për vendin pritës (Black dhe Gent 2005).

Këto probleme çojnë në pyetjen se si mund të përkufizohet rikthimi efektiv dhe i qëndrueshëm. Në bazë të përkufizimeve që kanë bërë autorë si Black dhe Gent që janë marrë me rikthimin, me rikthim efektiv dhe të qëndrueshëm do të kuptonim që individët e rikthyer në vendin e origjinës, të mos përpiqen të emigrojnë përsëri, por ta ndërtojnë jetën e tyre në atdhe. Më specifikisht, do të thotë së në vendin e lindjes duhet të gjejnë kushte socio-ekonomike të përshtatshme për të ndërtuar një të ardhme të mirë. Midis kushteve sociale dhe

ekonomike do të përmendnim punësimin, strehimin dhe shërbimet kryesore si uji, rrugët, dritat, edukimi dhe shërbimi shëndetsor, si edhe sigurinë për jetën e individit dhe familjarëve të vet. Është e rëndësishme që këto kushte të kenë një farë standardi matës, pasi duke qenë se kthehen nga vende më të zhvilluara se vendi i tyre, emigrantët kërkojnë ta ruajnë deri në një farë mase, në mos tërësisht nivelin e jetesës që kishin në vendin pritës (shih Black dhe Gent 2004, f. 12-14).

Duhet të theksojmë se kur rikthimi është i vullnetshëm, apo kur të kthyerit kanë formim profesional ose janë arsimuar në vendin pritës, si edhe kur atyre iu ofrohet asistencë pas kthimit, atëherë ai mund të jetë më i qëndrueshëm, sesa kur këto faktorë mungojnë (shih po aty, f 17-18). Në këtë kontekst, rikthimi gjithashtu shihet si potencial për zhvillimin e vendit të origjinës, sidomos kur mund të ndihmojë në fitimin e trurit (brain gain) dhe të nxisë transferimin dhe investimin e kapitaleve të emigrantëve në vendet e tyre të origjinës (Black dhe Gent 2005). Mendimi pesimist se kthimi i emigrantëve do të shtojë papunësinë, tashmë është zëvendësuar me këndvështrimin pozitiv të studjuesve të cilët mendojnë se të kthyerit mund të lehtësojnë "modernizimin" e vendit të tyre të origjinës nëpërmjet të ardhurave që do të sjellin në vend, si edhe nëpërmjet eksperiencës dhe aftësive që kanë fituar në vendet e zhvilluara pritëse. Ky qëndrim shpjegon edhe projektet e shumta në mbështetje të kthimit të vullnetshëm të migrantëve, veçanërisht të njerëzve të kualifikuar (shih Ghosh, 2000 sipas de Zwager et. al. 2005, f. 57).

Ky qëndrim ndaj rikthimit shpjegon dhe mbështetjen financiare që iu është dhënë projekteve të shoqatës "Shpresë për të Ardhmen", e cila nga fillimi e deri më sot ka mbështetur riintegrimin ekonomik dhe shoqëror të të kthyerve në Shqipëri.

Elementet e mësipërme sqarojnë çështjen e rikthimit dhe kontekstin në të cilin kanë lindur nevojat për politika migratore si në nivelin europian, ashtu edhe përgjigjen e qeverisë shqiptare që paraqiten më poshtë.

3. Politikat Migratore

Fenomeni i migrimit ndikon në jetën e të gjitha palëve si të vendeve të origjinës ashtu edhe vendeve pritëse. Rënia e regjimeve komuniste në Europën Qendrore e Lindore u shoqërua me emigrimin e shumë europiano-lindorëve, midis tyre dhe shqiptarë, drejt Europës Perëndimore. Një pjesë e mirë e këtyre vendeve nuk kanë pasur eksperiencë me lëvizjen e njerëzve nga apo drejt territorit të tyre, përveç ish-kolonive dhe për këtë arsye janë gjendur të papërgatitura ndaj fenomenit. Si pasojë që nga 1989 e deri më sot janë marrë një sërë masash nga të dyja palët: dërguese dhe pritëse për rregullimin e lëvizjes dhe qëndrimit të migrantëve në vendin e tyre, si edhe për largimin e tyre në rastet kur iu është refuzuar qëndrimi apo kur ata kanë hyrë dhe qëndruar në vend në mënyrë të paligjshme. Politikat migratore kanë përfshirë plane veprimi në lidhje me lëvizjen dhe punësimin e qytetarëve nga njëri shtet në tjetrin, regjimin e vizave, legalizimin e qëndrimit të tyre, politikat e dëbimit, kthimit vullnetar dhe ripranimit. Që këto politika të jenë funksionale ka nevojë që palët dërguese dhe pritëse të bien dakord, veçanërisht në lidhje me rikthimin.

Mirëpo përveç rikthimit fizik të emigrantëve, shtetet ende nuk kanë specifikuar dhe zbatuar masa konkrete integrimi. Politikat migratore të vendeve të Evropës dhe të Shqipërisë në lidhje me rikthimin përqendrohen në rregullat për qëndrimin dhe largimin e imigrantëve nga vendet pritëse, pa u ndalur tek procesi i riintegritimit në vetvete, gjë që shpjegon domodoshmërinë e veprimtarisë së shoqatave si Shpresë për të Ardhmen që zhvillojnë projekte riintegrimi ekonomik e social për kategoritë e ndryshme të të rikthyerve. Para se të analizojmë veprimtarinë e shoqatës, më poshtë po bëjmë një përmbledhje të politikave të BE-së dhe Shqipërisë, ku bie në sy mungesa e atyre mbi riintegrimin.

3.1 Politikat e vendeve të Evropës në lidhje me kthimin e emigrantëve

Sipas Nenit 23 të Konventës në zbatim të Marrëveshjes së Shengenit të 14 qershorit 1985, shtetasve të vendeve të treta që nuk plotësojnë më kushtet për qëndrim do t'u kërkohet të largohen nga vendi, dhe nëse nuk largohen vullnetarisht, atëherë ata mund të dëbohen nga Pala Kontraktuese².

Po kështu, Plani i Veprimit për Kthimin³ është një dokument, i cili mbulon kthimin e detyruar dhe atë vullnetar. Sipas këtij dokumenti, kthimi vullnetar përkufizohet si "largimi i ndihmuar ose i pavarur në vendin e origjinës, në një vend tranzit apo në një vend tjetër të tretë me dëshirën e të kthyerit." Vetë plani përbëhet nga katër komponentët e mëposhtëm:

- Bashkëpunim i menjëhershëm i përforuar praktik duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe praktikat më të mira, trajnimin e përbashkët, ndihmën reciproke nga nëpunësit e emigracionit dhe operacione të përbashkëta të kthimit;
- Standarde minimale të përbashkëta për kthimin e parashikuar në periudhën afatgjatë, afatshkurtër ose afatmesme;
- Programe specifike të vendit;
- Bashkëpunim të përforuar me vendet e treta për kthimin.

Ky dokument shoqërohet dhe nga Komunikata mbi një Politikë Komunitare për Kthimin e Rezidentëve të Paligjshëm⁴, e cila nënvizon se projektet e suksesshme të kthimit kërkojnë të gjithë ose shumicën e elementëve të mëposhtëm:

- Këshillim dhe njoftim para kthimit
- Ndihmë trajnimi dhe punësimi
- Ndihmë për të udhëtuar dhe/ose rivendosur në vendin e origjinës
- Ndihmë për strehim
- Ndihmë të vazhdueshme dhe këshillim pas kthimit.

Gjithsesi, dokumentat më të saktë në lidhje me kthimin janë marrëveshjet dypalëshe të ripranimit, të firmosura midis një shteti anëtar të BE, ose jo dhe një vendi origjine si Shqipëria. Vendi i parë që kërkoi të firmosej një marrëveshje ripranimi me Shqipëri ishte Italia, e cila u pasua dhe nga Zvicra (2000), Gjermania (2002), Mbretëria e Bashkuar (2003) e të tjera. Marrëveshjet dypalëshe tashmë janë zëvendësuar nga Marrëveshja e Ripranimit midis BE dhe Shqipërisë, e cila ka hyrë në fuqi në fillim të korrikut 2006. Sipas kësaj marrëveshje, Shqipëria

² IOM, Guidë për Instrumentat e Zgjedhura Ligjore të BE-së mbi Migracionin. Vienna: IOM, gusht 2005, f. 45.

³ Dok. i Këshillit Nr. 14673/02 (miratuar më 28.11.2002).

⁴ Com (2002) 564 final, 14.10.2002.

duhet të pranojë të gjithë të kthyerit nga vendet e BE-së, të cilëve iu është refuzuar qëndrimi në këto vende.

Teksti i marrëveshjes, ashtu sikurse dhe dokumentat e tjera të paraqitura më lart, nuk merr parasysh se çdo të ndodhë me të kthyerit pasi ata të gjenden në vendin e tyre të origjinës. Por, ndryshe nga dokumentat e tjera, nënshkrimi i kësaj marrëveshje është shoqëruar me programe ndihme për institucionet shqiptare, në mënyrë që Shqipëria të jetë në gjendje të respektojë kushtet e kësaj marrëveshje. Projekti më i madh titullohet “Lufta kundër migracionit të parregullt në Shqipëri dhe në rajon: Mbështetje e shënjestruar për rritjen e kapaciteteve në kuadër të mbështetjes së ripranimit në Shqipëri”, financuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria e Brendshme dhe Decentralizimit e Greqisë dhe të zbatuar nga IOM Tirana. Projekti përbëhet nga katër komponentë, të cilat përfshijnë kërkimin mbi politikat e kthimit në Shqipëri, rritjen e kapaciteteve për ripranimin, mbështetjen për Ministrinë e Brendshme për ripranimin dhe mekanizmat e riintegritimit për emigrantët shqiptarë të kthyer. Për komponentin e riintegritimit është kërkuar dhe bashkëpunimi i shoqatës “Shpresë për të Ardhmen”, si një nga aktorët joqeveritarë me përvojën më të madhe në fushën e riintegritimit të të kthyerve.

3.2 Politikat e shtetit shqiptar në lidhje me emigrantët e kthyer

Ashtu si edhe vendet pritëse, shteti shqiptar gjendet përballë fenomeneve si emigrimi dhe rikthimi, të cilat kërkojnë politika aktive për zbulimin e faktorëve që mund ta bëjnë rikthimin të qëndrueshëm vetëm nëpërmjet masave dhe bërjes së politikave riintegruese, që të garantojnë qëndrueshmërinë. Këto masa kanë munguar në Shqipëri, deri në 2005 kur u hartua dhe miratua Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin, i cili përmban disa masa specifike për riintegritimin e emigrantëve të kthyer. Përpara saj, të rikthyerit përmenden vetëm përciptazi në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Formimit Profesional, ku në nënkapitullin mbi Shtrirjen e Formimit Profesional, pika 3 thotë:

3. Krijimi i mundësive për formim profesional për grupet e popullsisë me probleme socio-ekonomike. Aktualisht grupe të veçanta të popullsisë të mbështetur me status dhe kuadër ligjor përkatës kanë pak hapësirë në sistemin e formimit profesional. Grupe të veçanta sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen: personat me aftësi të kufizuara, nënat me shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura; personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi; vajzat nëna të papuna; vajza dhe gra të trafikuar; gra të divorcuara me probleme sociale; emigrantë që kthehen me probleme ekonomike; të sapodiplomuar, të paorientuar në tregun e punës; ish të burgosur. Në të ardhmen shteti do të synojë të mbështesë këto grupe nëpërmjet: (i) aplikimit të tarifave të reduktuara në institucionet e formimit profesional; (ii) dhënies së përparësisë për përfshirjen në programe të

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

tjera të tregut të punës që zbaton MPÇS. Me këtë synohet punësimi i tyre dhe integrimi në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.

Ndërkohë, edhe vetë Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin, e cila në shtatë masat ku trajtohen çështjet e rikthimit, vetëm në 4 prej tyre flitet specifikisht për emigrantët e rikthyer. Kështu, masa 4 flet për vlerësimin e mundësive konkrete që ofron Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional për emigrantët e kthyer, masa 6 flet për propagandimin e mundësive që iu ofrohen shqiptarëve në formën e shërbimeve nëse ata rikthehen, duke nënkuptuar vetëm ato publike, masa 8 flet për zgjerimin e shërbimeve riintegruese në mënyrë që të garantohet kthimi i përhershëm dhe masa 9 shtyn për ngritjen e kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe të zyrave të tij rajonale e lokale (shih Shtojca 1). Edhe pse vlerësohen përpjekjet e qeverisë shqiptare për të trajtuar më në fund çështjen e riintegrimit të emigrantëve të kthyer, përmbajtja e këtyre masave është shumë e përgjithshme dhe aktivitetet që janë parashikuar nuk e zgjidhin dhe ndihmojnë procesin e riintegrimit të të kthyerve. Për më tepër këto masa nuk përfshijnë aspak organizmat e ndryshme joqeveritare, të cilat janë marrë dhe merren me emigrantët e rikthyer siç është Shpresë për të Ardhmen duke bërë që përpjekja e institucioneve publike të fillojë nga zero. Gjithsesi masat duhet të kenë filluar të zbatohen gjatë këtij viti (2006), që do të thotë se asistenca për riintegrim nga ana e shtetit shqiptar është në gjenezë.

Një vështrim i përgjithshëm në politikat migratore tregon mungesën e masave dhe projekteve konkrete riintegruese, që janë ende në fillimet e tyre, edhe pse procesi i rikthimit ka filluar në Shqipëri paralelisht me atë të emigrimit. Për të plotësuar këtë boshllëk institucional ka qenë dhe është ende e nevojshme ndërhyrja e organizmave joqeveritare si Shpresë për të Ardhmen, të cilat kanë qenë të parat që kanë identifikuar problemin, kanë analizuar kompleksitetin e tij dhe kanë hartuar plan-projekte, të cilat janë zbatuar me qëllim që të mbështeten emigrantët e kthyer në procesin e mundimshëm të riintegrimit ekonomik dhe social në Shqipëri.

3.3 Lidhja mes institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse

Komunikimi midis institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse është parë si vendimtar në politikat e kthimit. Kjo është ligjëruar nga ana e Këshillit të Europës nëpërmjet Vendimit të Këshillit të 26 majit 1997 “Mbi shkëmbimin e informacionit në lidhje me ndihmën për riatdhesimin vullnetar të shtetasve të një vendi të tretë”, ku nënvizohet se informacioni duhet të sigurohet për të gjitha autoritetet zbatuese të programeve (dmth organizatat

joqeveritare dhe ato ndërkombëtare) përkrah institucioneve shtetërore të palëve.⁵

Po kështu në kuadrin e mbështetjes për kthimin vullnetar, shumë vende pritëse kanë bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare si Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), e cila prej vitesh ka vënë në zbatim programin e asistencës së kthimit vullnetar (VARRP), që lehtëson kthimin e atyre emigrantëve shqiptarë të cilëve iu është refuzuar qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar dhe duan të kthehen në Shqipëri.

Në kuadër të këtij programi, por edhe të qëllimeve të vetë IOM-it është synuar dhe arritur ndërtimi i rrjetit të shoqatave që merren me migracionin në Shqipëri, të cilat takohen çdo muaj dhe bëhet shkëmbimi i informacionit dhe nxitet bashkëpunimi midis tyre dhe ministrive të linjës që merren me çështjet e migracionit si Ministria e Brendshme dhe ajo e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Po kështu IOM ka bashkëpunuar me disa nga këta aktorë, si Shpresë për të Ardhmen në projektet e riintegritimit, brenda kuadrit të projektit HLWG 2002 dhe VARRP.

Vetë Shpresë për të Ardhmen ka firmosur në mënyrë individuale një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrat Rajonale të Punësimit në Tiranë dhe Shkodër, në bazë të së cilës të dyja palët do të angazhohen në shërbime reciproke si edhe është ftuar të marrë pjesë në Task Forcën e ndërtuar për hartimin e një dokumenti politik që do të çojë në hartimin e një Plan Veprimi konkret për Riintegrimin e Emigrantëve të Kthyer, si një nga shoqatat me më shumë eksperiencë në fushë. Gjithsesi, duhet të theksojmë se përfshirja e aktorëve joshtetërorë në ndërtimin e strategjive të kësaj natyre janë sporadike dhe të nxitura nga vetë OJF-të dhe IOM Tirana dhe jo me iniciativë të institucioneve shtetërore. Mosangazhimi i aktorëve me eksperiencë të gjerë si Shpresë, natyrisht që ndikon për keq në cilësinë e veprimeve shtetërore.

⁵ Po aty, f. 56.

4. Qëllimi dhe misioni i shoqatës

Shoqata Shpresë për të Ardhmen është ndër të parat që kanë identifikuar problemin e ndihmës për të kthyerit nga emigrimi, dhe kanë ndërtuar programe konkrete për t’u ofruar shërbime këtyre të kthyerve me qëllim që të lehtësohet procesi i riintegrimit në vendin e tyre, por edhe që rikthimi të jetë i qëndrueshëm dhe jo i përkohshëm. Projekti që më pas u kthye në shoqatë lindi në kushtet, kur vende të ndryshme evropiane si Zvicra dhe Gjermania filluan të kthejnë një numër të konsiderueshëm shqiptarësh të padëshiruar në vitin 1998. Para se të bëjmë një analizë të punës së shoqatës, do të paraqesim një përshkrim të shkurtër të lindjes së saj, qëllimit, parimeve të punës, projekteve me të cilat është marrë, strukturën dhe mënyrën e punës, si edhe aktivitetet ekonomike dhe shoqërore që ka zhvilluar në funksion të qëllimit të vet.

4.1 Si lindi Shpresë për të Ardhmen

Patrice de Mestral shërbente si prift dhe këshilltar nëpër burgjet zvicerane, derisa një ditë ai filloi të mendonte rreth mënyrës sesi mund t’i ndihmonte të rinjtë e shumë shqiptarë që gjendeshin në këto burgje dhe pritnin të riatdhesoheshin në Shqipëri. Edhe pse rregullat e shtetit zviceran do t’i kthenin ata në shtëpi, arsyeja kryesore e largimit, arsyeja ekonomike, ishte ende e vlefshme dhe nëse këta të rinj nuk do të ndihmoheshin, kthimi i tyre do të ishte i pasuksesshëm dhe asgjë nuk garantonte se ata nuk do ta provonin përsëri të riktheheshin në Zvicër apo në vende të tjera të rajonit nëpërmjet rrugëve të paligjshme.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

Kjo perspektivë e trishtë shërbeu si shtysa për ndërtimin e projektit “Kape të Ardhmen”, i cili filloi në tetor të vitit 1998, por që mundi të hapte zyrën e vet të Informacionit, Këshillimit dhe Mbështetjes për të rinjtë e riatdhesuar nga Zvicra në Prill 1999. Ndërkohë shoqata social humanitare “Shpresë për të Ardhmen” u legalizua po atë vit në muajin nëntor për të zhvilluar Projektin “Kape të Ardhmen”. Në mbështetje të këtij projekti u zhvillua një anketë në bazë intervistash për periudhën 22 nëntor – 20 dhjetor, rezultatet e së cilës vërtetuan nevojën për projektin “Kape të ardhmen” që synonte dhënien e ndihmës për riintegrimin e emigrantëve të kthyer.

Në fazën përgatitore të projektit de Mestral gjeti mbështetjen e një punonjëseje sociale zvicerane, Franciska Camenzind e cila në atë periudhë ndodhej në Shqipëri, si edhe nga Irena Dono, e cila në atë kohë u punësua si administratore dhe më vonë drejtuese e projektit. Ishte de Mestral ai që u mor me mbledhjen e fondeve për dy vitet e para. Duhet theksuar se edhe sot e kësaj dite ai vazhdon të mbledhë fonde për projektin “Kape të Ardhmen”. Camenzind luajti një rol të rëndësishëm në fazën e parë të projektit. Ajo së bashku me de Mestral u morën me rekrutimin dhe trajnimin e stafit dhe ngritën projektin “Kape të Ardhmen”.

Në fillimet e veta, projekti ishte shumë i vogël dhe modest. Punonjësit e tij ishin të punësuar me kohë të pjesëshme, dhe fondet e lëvruara nuk ishin të mëdha. Po kështu, në fillim grupi i trajtuar ishin vetëm të kthyerit me forcë nga Zvicra. Ky grup ishte shumë i vështirë, pasi të rinjtë vinin nga një eksperiencë traumatike nga burgjet e Zvicrës dhe ishin shumë dyshues për misionin e qëllimet e shoqatës. Periudha e parë ka qenë një periudhë e ngritjes së besimit midis përfituesve të mundshëm dhe krijimin e përforcimin e një reputacioni pozitiv për të tërhequr të kthyerit pranë vetes dhe për t’u ofruar atyre shërbimet e riintegrimit, të menduara nga shoqata.

Vetëm me kalimin e kohës, konsolidimin e aktivitetit të shoqatës dhe rezultateve të para me të kthyerit, “Shpresë për të Ardhmen” mundi të fitojë një pozicion të respektuar midis shoqatave më të suksesshme që merren sot me emigrantët. Që nga 1999 e këtej Shpresë për të Ardhmen ka bashkëpunuar me donatorë të ndryshëm, që kanë financuar “Kape të Ardhmen” dhe iniciativa të tjera të ngjashme që kanë synuar riintegrimin ekonomik e social të të rikthyerve nga Zvicra, por edhe nga vende të tjera si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia, si edhe migrantët e brendshëm, të cilët janë vendosur gjatë viteve të tranzicionit në kryeqytet dhe në rrethinat e tij.

4.2 Misioni dhe objektivat

Misioni i shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” është:

Të kontribuojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të emigrantëve shqiptarë të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, si edhe të ndihmojë në integrimin profesional e social të migrantëve të brendshëm.

Për realizimin e këtij misioni shoqata e ndërtoi aktivitetin e vet në statutin, i cili si fillim përmbledhte objektivat e mëposhtme:

- Të ndihmojë në riintegrimin në shoqërinë shqiptare të migrantëve të kthyer nga vende të ndryshme evropiane, kryesisht nga Zvicra, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.
- Të zhvillojë perspektiva të reja profesionale dhe arsimore për të ardhmen e këtyre të rinjve, me qëllim që t’i ndihmojë të gjejnë dhe rizbulojnë rrënjët e tyre në Shqipëri.
- Të krijojë alternativa punësimi për këta shqiptarë të riatdhesuar si hap i parë drejt riintegrit të tyre në Shqipëri.
- Të promovojë riintegrimin e tyre social.
- Të bëjë objekt diskutimi publik problemin e të rinjve shqiptarë që nuk e shohin të ardhmen e tyre në Shqipëri, por duan të migrojnë në vende të tjera.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e shqiptarëve për rreziqet e migrimit të paligjshëm.

Këto objektiva fillestare janë përpunuar dhe në statutin e ri të shoqatës gjejmë se shoqata gjithashtu synon:

1. Të ofrojë shërbime këshillimore psikosociale, ditore dhe rezidenciale për grupet në nevojë.
2. Të zhvillojë perspektiva të reja profesionale dhe arsimore për të ardhmen e shqiptarëve të riatdhesuar, me qëllim që t’i ndihmojë ata të gjejnë dhe rizbulojnë rrënjët e tyre në Shqipëri si edhe të ndihmojë migrantët e brendshëm për rritjen e aftësimin profesional dhe nxitjen e punësimit.
3. Të krijojë alternativa punësimi për këta shqiptarë të riatdhesuar dhe migrantë të brendshëm, si hap i parë i riintegrit të tyre.
4. Të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të bizneseve të vogla në Shqipëri, me qëllim që të sigurojë një riintegrim të qendrueshëm të emigrantëve të kthyer, të punësuar pranë këtyre bizneseve.
5. Të inkurajojë shoqëritë dhe bizneset e të gjitha llojeve në vende të ndryshme evropiane që të investojnë dhe financojnë për rindërtimin e shoqërisë shqiptare.

6. Të bëjë objekt të diskutimeve publike problemin e shumë shqiptarëve që nuk shohin ndonjë të ardhme të mirë në Shqipëri dhe migrojnë kështu në vendet e tjera. Gjithashtu të rrisë ndërgjegjësimin e shqiptarëve për rreziqet dhe dëmet e migrimit të paligjshëm.
7. Të llojë me organizmat shtetërorë për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve të kthyer dhe migrantëve të brendshëm.
8. T’i ndihmojë shqiptarët të rizuojnë krenarinë e të qenit shqiptar dhe t’i nxitë ata të marrin pjesë aktive në krijimin e së ardhmes së tyre në Shqipëri.

4.3 Grupet Përfituese

Përfituesit kryesorë të shoqatës janë emigrantët e kthyer forcërisht dhe të kthyerit vullnetarë nga vendet e Evropës Perëndimore, kryesisht nga Zvicra, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia. Në raste të veçanta janë asistuar edhe emigrantët të kthyer nga vende të tjera si Greqia, Belgjika, Irlanda, të referuar nga Drejtoria Rajonale e Punësimit. Po kështu, nga projektet e shoqatës përfitojnë edhe migrantët e brendshëm, që kanë probleme integrimi në qytetet e mëdha dhe në metropolin shqiptar, Tiranën. Njëkohësisht nga këto projekte kanë përfituar sipërmarrësit që janë përfshirë në punësimin e klientëve të shoqatës dhe të rinjtë universitarë. Nga të gjitha grupet përfituese, prioritet iu është dhënë grave, të cilat mund të kenë probleme më të theksuara riintegrimi për shkak të traditës patriarkale të shoqërisë shqiptare.

4.4 Parimet dhe metoda e punës

Projekti është i bazuar në atë që njihet si “Koncepti i Riintegritimit dhe Transformimit të Ndjeshëm”. Ky model nënkupton se nevojat bazike të qenieve njerëzore nuk janë thjesht materiale (niveli i gjelbër), edhe pse janë ato që preferohen më tepër nga ndihma humanitare: ushqimi dhe strehimi. Edhe pse vihet re se shumica e projekteve të zhvillimit ndalen te niveli strukturor (niveli blu) duke u përqendruar tek edukimi, trajnimi dhe qeverisja e mirë. Gjithsesi të gjitha këto përpjekje të projekteve do të ishin të kota nëse grupi i trajtuar ka bllokim emocional dhe vetizolohen emocionalisht (niveli i kuq). Po kështu, studime të ndryshme kanë treguar se mungesa e motivacionit dhe e vizionit për të ardhmen është një nga shkaqet kryesore të dështimit të shumë projekteve (niveli i verdhë). Për këtë arsye të gjithë projektet e riintegritimit kanë nga një komponent projekti kushtuar nivelit material (të gjelbër), strukturor (blu), emocional (i kuq) dhe atij vizionar (i verdhë), me anë të të cilave Shpresë për të Ardhmen është përpjekur të japë ndihmën e parë për të rikthyerit, asistencë për formim profesional dhe punësim, riintegrim social me anë të aktiviteteve të shumta e të ndryshme në grup dhe ofrimi i një perspektive për të ardhmen në Shqipëri.

Aktiviteti i Shpresë për të Ardhmen mbështetet në parimet bazë si më poshtë:

- Ofrimi i kohës së mjaftueshme për procesin e riintegritimit: 9 muaj është periudha minimale për një individ për t’u përshtatur në një situatë të re. Duhet të paktën tre vjet për një komunitet që të kalojë përmes dhe të përshtatet me marrëdhëniet e reja të krijuara.
- Ofrimi i mundësive për të kapërcyer izolimin: psh takimet “Shtëpi e Hapur”. Ndërtimi i besimit është një faktor i rëndësishëm në nivel individual, por edhe atë komunitar. Duhet krijuar mundësitë që kjo të ndodhë.
- Pranimi vetëm i pjesëmarrësve të motivuar: motivimi është kyç për suksesin, ai mund të nxitet, por nuk mund të krijohet.
- Krijimi i përfitimit të përbashkët: projekti duhet të jetë me fitim si për përfituesit e projektit ashtu edhe për punëdhënësit.
- Bërja kujdes që të ketë trajtim të barabartë: vëmendje duhet t’u jepet atyre që kanë më shumë nevojë. Përzgjedhja mund të shkaktojë tensione të reja, të cilat duhen evituar.
- Integrimi i modeleve të riintegritimit: Ballkani është vend me kultura e zakone të ndryshme, edhe në nivel vendor krahasina të ndryshme kanë specifikat e tyre që duhen marrë parasysh gjatë zbatimit të projektit dhe komunikimit me përfituesit e projekteve të riintegritimit.
- Përdorimi i teknikave të përdorura në nivel lokal për të garantuar sukses: çdo vend ka detajet e veta, dhe një i huaj sado i zoti, nuk arrin t’i vërejë e zbatojë, edhe pse ato janë të domosdoshme për suksesin e projektit. Për këtë arsye bëhet e domosdoshme punësimi i stafit lokal për zbatueshmërinë e projektit.

Këto parime kanë mbrytur mënyrën sesi stafi i Shpresë për të Ardhmen ka vepruar deri më sot. Puna është e ndarë në faza dhe që nga kontakti i parë e deri në përfundimin e kontratës, përfituesit janë nën përkujdesjen dhe kontrollin e punonjësve të shoqatës, të cilët u qëndrojnë pranë për çdo gjë që mund të lehtësojë periudhën fillestare të kthimit të tyre.

Kështu, kontakti i parë që një i kthyer ka me Shpresë për të Ardhmen bëhet nëpërmjet punonjësve sociale. Pavarësisht nëse personi përfiton apo jo nga projektet e shoqatës, ai ose ajo zhvillon një bisedë me punonjësën sociale, e cila punën e vet e ka të organizuar në faza. Në fazën e parë (kontakti i parë) zhvillohet intervista, ku bëhet një prezantim i dyanshëm, dhe punonjësja sociale jep informacion mbi aktivitetin e shoqatës, projektet dhe shërbimet që ofrohen, më pas diskutohet mbi gjendjen aktuale të klientit, bëhet identifikimi i nevojave të tij/saj, i jepet informacion mbi tregun e punës dhe mekanizmat e tij, kurset e formimit profesional, kurset e tjera të ofruara dhe mbështetje emocionale. Pas kësaj, ajo bën plotësimin e kartelës personale dhe i jep klientit/es materiale si fletëpalosje, buletine, një formular ku emigranti i kthyer shkruan historinë e emigrimit etj.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

Para se të ofrojë mbështetjen e shoqatës, punonjësja sociale bën një vlerësim paraprak, nëse personi mund të përfitojë nga projektet e shoqatës, dhe nëse po i jep atij/asaj listën e dokumenteve që duhet të paraqesë për aplikim. Çdo muaj bëhet nga i gjithë stafi vlerësimi i dokumentacionit dhe merret vendimi nëse personi do të përfitojë ose jo. Në fillim, kur numri i aplikuesve ishte i pakët, ndihma u ofrohej pothuajse të gjithë personave, të cilët plotësonin kriteret, por me kalimin e viteve numri i aplikuesve është rritur në mënyrë të konsiderueshme, që do të thotë se përzgjedhja i çon klientët në listën e pritjes për përfitim. Renditja e personave në këtë listë bëhet në bazë të kriterit se kush është rregjistruar i pari. Gjithsesi, përjashtime janë bërë për individë që kanë pasur nevojë të menjëhershme për ndihmë.

Ndërkohë, agjenti i rrjetit të punës është personi në terren. Ai është përgjegjës për rekrutimin e klientëve, sidomos atyre të rretheve. Gjatë vizitave të përmuajshme në terren, ai takon persona që janë gjetur nga personi i kontaktit ose të tjerë që kanë mësuar për shërbimet e riintegritit dhe që duan të aplikojnë pranë shoqatës dhe u kontrollon atyre dokumentacionin. Nëse ata i përmbushin të gjitha kushtet për të përfituar, atëhere ai i fton të vijnë në zyrat e shoqatës, në mënyrë që të bisedojnë me punonjësën sociale, e cila do të shqyrtojë rastin e tyre. Edhe në rastin kur personi nuk i përmbush kushtet, përsëri ata ftohen nga agjenti të vizitojnë zyrën për konsulencë dhe referim në institucione të tjera, të cilat mund t'i ndihmojnë.

Më pas, agjenti i rrjetit të punës përfshihet në proces kur klientët janë përzgjedhur për të përfituar dhe janë në fazën e gjetjes së punës. Agjenti merr listën e klientëve të rinj bashkë me kontaktet e tyre. Në Berat dhe në Shkodër puna është lehtësuar nga ndihma e dy pikave kontakti, të cilat ndihmojnë në ndërlikdhjen me klientët. Personat njoftohen paraprakisht për ardhjen e agjentit, dhe kur ai shkon, bisedojnë për mundësitë e punësimit të klientit në bazë të aftësive, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës që ka secili. Agjenti bën sugjerimet e veta në lidhje me mundësitë e punësimit në qytetin/zonën ku banon klienti dhe fillojnë negociatat me punëdhënësit.

Ndodh që punësimi të gjendet nëpërmjet ndërmjetësimit të agjentit të punës, por duke pasur parasysh se shumica e bizneseve të vogla dhe të mesme në Shqipëri veprojnë në bazë lidhjesh personale familjare dhe/ose shoqërore, shumica e klientëve e gjejnë vetë një punë. Vështirësia e gjetjes së punës nëpërmjet ndërmjetësimit vjen si pasojë e mungesës së besimit tek aftësitë e institucioneve shtetërore si Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat e Punësimit për përzgjedhjen dhe rekomandimin e personave të duhur në bazë të kërkesës së punëdhënësit, si edhe për shkak të natyrës informale të një pjese të mirë të tregut të punës shqiptar, e cila përforcon rolin e njohjeve personale si mjetin kryesor për gjetjen e një vendi pune në Shqipëri.

Gjithsesi, pavarësisht nëse i kthyeri e gjen vetë punën apo nëpërmjet ndërmjetësimit të shoqatës, është agjenti ai që finalizon me anë të një kontrate punësimit e klientit pranë biznesit të punëdhënësit, apo kontratën sipas të cilës punëdhënësi do t’i mësojë profesionin klientit gjatë kësaj periudhe kohe, në rast se klienti nuk ka asnjë eksperiencë pune. Njëkohësisht lidhet dhe një kontratë me klientin. Kjo kontratë me të dyja palët nënkupton se nga punëdhënësi jepet një rrogë minimale dhe garancia e të punuarit aty për të gjithë nëntë muajt e kontratës me shoqatën, ndërkohë që shoqata plotëson pjesën tjetër.

Deri më sot shoqata është ndihmuar nga dy persona kontakti ose ndihmës monitorues një në Berat, një në Shkodër si edhe një ndihmës monitorues në Tiranë, që janë dhe vendet me më shumë klientë dhe ku fluksi është i madh dhe i papërbalueshëm nga agjenti i punësimit. Këta ndihmojnë dhe lehtësojnë punën e shoqatës për gjetjen e klientëve në rrethin e tyre. Këta djem kanë qenë përfitues të shoqatës dhe kanë pranuar ofertën e saj për t’i ndihmuar në misionin e tyre. Kjo përzgjedhje është bërë me qëllim, pasi duke dalë nga i njëjti grup interesi me të kthyerit forcërisht, ata e kanë lehtësuar shumë punën e shoqatës përsa i përket kontaktimit dhe rekrutimit të klientëve të rinj.

Duke qenë edhe vetë të kthyer forcërisht dhe përfitues të mëparshëm të shërbimeve të shoqatës, ata janë më pranë problemeve të klientëve të rinj, i kuptojnë më mirë dhe janë më të gatshëm për t’i ndihmuar. Vendosija e tyre si persona kontakti, ka bërë që shumë klientë t’i afrohen shoqatës dhe të kenë besim te puna dhe qëllimet e saj, gjë që e ka shtyrë shoqatën të mendojë se ka vepruar drejt në përfshirjen e tyre në procesin e riintegritimit të bashkëqytetarëve të tyre.

Puna konkrete në të cilën janë përfshirë ndihmësit përbëhet nga kërkimi joformal mbi personat që janë kthyer kohët e fundit nga emigrimi, sidomos nga Zvicra apo Gjermania. Gjithsesi, tashmë ka plot persona që falë reputacionit që shoqata dhe pikat e kontaktit kanë krijuar, vijnë e takohen vetë me ta, për të pyetur më shumë për mundësinë e përfshirjes në projektet e shoqatës. Kontakti u shpjegon se çfarë bën shoqata dhe se çfarë dokumentesh duhet të përgatisin për t’u paraqitur te shoqata, si edhe adresën e shoqatës në Tiranë dhe Shkodër.

Personat e kontaktit e shoqërojnë agjentin e rrjetit të punës të shoqatës në vendin e punës së klientit dhe janë të pranishëm në firmosjen e kontratës. Më pas, kur firmoset kontrata, ata shkojnë të paktën një herë në muaj te vendi i punës së klientëve për të parë nëse shkojnë apo jo në punë, dhe ia raportojnë të gjitha agjentit të punës. Përveç mbarëvajtjes së punës, ata zhvillojnë herë pas here biseda me përfituesit duke i pyetur nëse janë të kënaqur apo jo, çfarë kanë ndërmend të bëjnë për të ardhmen, duke i referuar më pas te shoqata, në

mënyrë që të mund t'u ofrohen shërbime sa më të mira klientëve. Kontaktet me ta nuk ruhen vetëm gjatë periudhës së kontratës, por edhe më pas duke qenë se njerëzit vijnë të pyesin, ose ftohen për të marrë pjesë në aktivitetet shoqërore si takimet "Shtëpi e Hapur", apo kur në shoqatë vijnë vizitorë të huaj që janë të interesuar për aktivitetin e saj.

Gjatë punës me të kthyerit, sidomos të kthyerit forcërisht është vënë re se shumë prej tyre janë larguar apo dëbuar nga vendet evropiane pa iu dhënë mundësia të zgjidhin plot çështje personale e ligjore. Si pasojë, këta njerëz kanë kërkuar ndihmën e shoqatës, e cila për t'i ardhur në ndihmë ka punësuar një jurist, i cili do të ofrojë këshillim ligjor për të gjithë klientët që kanë nevojë. Po në të njëjtën frymë, duke parë se rikthimi është një përvojë traumatike, e cila vështirëson riintegrimin në vend, shoqata u ofron atyre që kanë nevojë këshillim psiko-social, i cili është parë si shumë i dobishëm në rastet midis të rikthyerve.

Marrëdhëniet midis stafit

Marrëdhëniet midis punonjësve në zyrën e shoqatës mund të përkufizohen si pozitive, bashkëpunuese dhe të suksesshme. Të gjithë punonjësit pohojnë se kjo është meritë e drejtores ekzekutive, e cila ka krijuar një mjedis pune të përshtatshëm dhe kushte shumë të mira. Ka një shpërndarje të drejtë të përgjegjësive, dhe secili nga stafi i njeh detyrat e veta, për të cilat mban përgjegjësi të plotë.

Pavarësisht nga ndarja e detyrave, ka një frymë të gjerë bashkëpunimi, ku të gjithë marrin pjesë në shqyrtimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e klientëve. Informacioni shkëmbehet rregullisht, mendimi i të gjithëve dëgjohet me vëmendje dhe diskutohet për të arritur në përfundime me të cilat bien dakord të gjithë në të mirë të mbarëvajtjes së punës me projektet. Pra, të gjithë mundohen të kuptojnë njëri-tjetrin, idetë e secilit merren parasysh dhe janë të gjithë të përfshirë në vendimmarrje.

Pra, vihet re se stafi është i përkushtuar. Kriteret e punës janë korrektësia dhe drejtësia dhe çdo gjë bëhet në bazë të procedurave dhe kriterëve dhe bashkëpunohet për të gjitha çështjet e rëndësishme. Edhe pse të pyetur veçmas, të gjithë e përkufizojnë raportin mes tyre si të ngrohtë, plot mirëkuptim dhe për të përdorur një nga shprehjet e tyre janë "si një familje", gjë që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në suksesin e punës së tyre si ekip dhe përmbushjen e misionit të shoqatës për të cilën punojnë.

4.5 Projektet e zbatuara

“Kape të Ardhmen” është projekti fillestar i shoqatës, dhe boshti i aktivitetit të saj që nga 1999 e në vazhdim. Si fillim, ky projekt ofronte shërbime të riintegritit ekonomik dhe social për emigrantët e kthyer forcërisht nga Zvicra. Në vijim u përfshinë edhe të rikthyerit vullnetarisht. Shërbimet që u ofroheshin këtyre emigrantëve ishin: Formim profesional nëpërmjet punësimit të klientëve pranë një punishteje, ku atyre u është paguar 60% e rrogës nga shoqata, dhe pjesa tjetër nga punëdhënësi me kusht që ata të mbaheshin në punë për një periudhë fikse prej 9 muajsh, kurse të kualifikimit profesional; kurse trajnimi si gjuhësh të huaja, kompjuteri, patente etj; dhe shërbime sociale. Njëkohësisht, emigrantëve të kthyer u kërkohet të shkruanin historitë e tyre të emigrimit, shkrimi i të cilave është bërë tashmë pjesë e projektit “Kape të Ardhmen”.

“Lulet zbukurojnë mjedisin” ishte miniprojekti i parë i shoqatës që u realizua në periudhën prill-gusht 1999. Gjatë periudhës emergjente të luftës në Kosovë, zyra ofroi shërbime afatshkurtra punësimi për Kosovarët në Tiranë. Kosovarët e përzgjedhur nga punonjësit socialë të shoqatës u angazhuan me punime në zonën përpara pallatit ku ndodhej zyra, duke e kthyer atë në një lulishte të këndshme. Ky projekt bëri që në një periudhë stresi e pasigurie, kosovarët e shpërngulur t’i riktheheshin rutinës të së përditshmes nëpërmjet marrjes me punë, qoftë edhe përkohësisht.

VARRP ose Programi i Asistencës për Kthimin dhe Riintegrimin e të Kthyerve Vullnetarisht nga Mbretëria e Bashkuar, iniciuar nga IOM Londër u realizua në bazë të një marrëveshje midis Shpresë për të Ardhmen dhe IOM Tirana. Që nga nënshkrimi i kontratës së parë në 2003, IOM i ka referuar Shpresës për të Ardhmen raste emigrantësh të kthyer, të cilëve iu janë ofruar shërbime të lehtësimit të punësimit dhe mbështetjes financiare për punësimin e tyre, si edhe përfshirjen e tyre në gjithë aktivitetet e riintegritit shoqëror të organizuar nga shoqata të përmendura te projekti “Kape të Ardhmen”.

Grupi i punës i nivelit të lartë

Shpresë për të Ardhmen ka qenë një nga organizat shqiptare të përzgjedhura nga IOM Tirana për të bashkëpunuar në projektin “Nxitja e riintegritit të qendrueshëm në Shqipëri, Provincën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë, duke rritur kapacitetet e OJF-ve vendase për t’u siguruar shërbime të kthyerve”, e mbështetur nga Komisioni Evropian në kuadrin e projektit të Grupit të Punës të Nivelit të Lartë. IOM Tirana zhvilloi trajnime me organizatat e përfshira në këtë projekt si edhe i pajisi me kompjutera dhe pajisje të tjera. Në kuadrin e këtij projekti shoqata asistoi 11 persona, duke i vendosur në vende pune për 9 muaj.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

ALNIMA ishte një iniciativë e Komisionit Evropian, ndryshe i quajtur Projekti 2002/HLWG/26 në bashkëpunim me Vendet e Treta në fushën e imigracionit. Projekti përfshinte tre vende: Marokun, Nigerinë dhe Shqipërinë. Vetë projekti synonte të ofronte mbështetje për emigrantët e përjashtuar nga Italia në mënyrë që ata të kishin një riintegrim sa më të lehtë dhe të qëndrueshëm në vendet e tyre të origjinës. Objektivat e projektit ishin krijimi i rrjetit të enteve publike e private në Itali dhe në vendet e origjinës që të mundësohej punësimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm për të rikthyerit, njohja e tregut të punës në mënyrë që të organizohej formimi profesional i të përjashtuarve në bazë të kërkesave të tregut, sensibilizimi i grupeve më të prirura për emigrim të parregullt për rreziqet dhe padobishmërinë e një veprimi të tillë sikurse dhe sensibilizimi i atyre që do të rikthehen për atë që i pret në vendin e origjinës, si edhe nxitja e zhvillimit ekonomik në vendet e origjinës.

Në partneritet me organizatën italiane COOPI, shoqata është përfshirë jo vetëm në Projektin ALNIMA, të mbështetur nga Komisioni Evropian (Grupi i Punës i Nivelit të Lartë) por së fundmi dhe në projektin ALBAMAR, të mbështetur nga Komisioni Evropian në kuadrin e Programit AENEAS. Ky projekt synon mbështetjen e integruar për emigrantët shqiptarë të kthyer forcërisht dhe vullnetarisht nga Italia. Mbështetja do të ofrohet në kuadrin e ndihmës psikologjike dhe futjen në tregun e punës në Shqipëri. Emigrantëve do t’u ofrohet këshillim psikologjik dhe trajnim profesional që në Itali, dhe më pas në Shqipëri do të ndiqen nga Shpresë për të Ardhmen dhe do të ndihmohen në riintegrimin e tyre social-ekonomik në vend. Projekti sapo ka filluar dhe shoqata është duke trajtuar kontigjentin e parë të klientëve.

“Hidhe Hapin” është një projekt që synon integrimin e grave migrante të brendshme në zonën e Laknasit (fshat 25 km larg Tiranës), duke iu ofruar atyre kurse formimi profesional dhe trajnime të tjera për të përmirësuar mundësitë e punësimit të tyre në vendbanim apo gjetkë. Kurset fillestare janë pasuar dhe nga kurse të tjera për ato gra dhe vajza që tregojnë aftësi të veçanta, duke iu dhënë një mbështetje për një periudhë nga 2 deri në 6 muaj.

Fillimisht janë trajnuar kryesisht gratë me nivel të ulët edukimi të cilat janë target grupi i këtij projekti me qëllim që të aftësohen për të gjetur punë më pas, të socializohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme sociale, të ndërgjegjësohen për rolin e tyre në familje e shoqëri, të krijojnë ndjenjën e vetvlerësimit dhe të edukohen me konceptin që kjo situatë e re e jetës është një sfidë e madhe por jo e pakapërcyeshme për to. Gjithashtu projekti Hidhe Hapin synon që të ofrojë mbështetje emocionale dhe akses të plotë në aktivitetet social-kulturore dhe edukuese të organizuara periodikisht nga shoqata.

Projekti **MIGRAVALUE**, i cili financohet nga Komisioni Evropian në kuadër të programit Interreg III B CADSES dhe ku përfshihen 14 partnerë evropianë synon menaxhimin e migracionit si mjetin kryesor për zhvillimin e integruar ekonomik e social të vendeve pritëse dhe atyre të origjinës, nëpërmjet nxitjes së investimeve nga ana e emigrantëve në vendin e tyre të origjinës, si edhe transferimin e eksperiencës së tyre nga vendet pritëse në atë të origjinës, si një masë reaguese ndaj fenomenit të rrjedhjes së trurit (brain drain). Emigrantët do të asistohen në menaxhimin e të ardhurave të tyre, si edhe do t’u ofrohet mbështetje në arritjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe ndihmë sociale. Do të përkufizohen modele ndërkombëtare për emigrantët, të cilët do të përdoren për të joshur emigrantët shqiptarë të kthehen dhe të investojnë në Shqipëri.

4.6 Donatorët

Donacionet private të mbledhura nga **de Mestral** ishin të parat burime financiare që mbështetën projektin “Kape të Ardhmen” dhe Shoqatën “Shpresë për të Ardhmen”. Sot de Mestral ende mbledh fonde nga donatorë privatë në Zvicër, por tashmë projekti është zgjeruar aq sa të ketë buxhete shumë më të mëdha se ç’mund të përballoheshin në fillim, kështu që Shpresë ka gjetur mbështetjen e disa donatorëve. Këta donatorë përfshijnë:

HEKS ose ndryshe Ndihma e Ndërkishës Zvicerane ka zhvilluar projekte që në 1993 në rajonin e Ballkanit, duke u përpjekur të ndihmojë në zhvillimin e forcimit të demokracisë në këto vende. Midis këtyre projekteve, qëndron edhe “Riintegrimi i refugjatëve dhe emigrantëve në Ballkan”. HEKS ka financuar gjithashtu projektin “Hidhe Hapin”. Përpos rolit të donatorit, HEKS e ka ndihmuar Shpresë për të Ardhmen gjatë negociatave me **IOM Tirana** dhe **EED** (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjelike Gjermane) për fonde që kanë mundësuar vazhdimësinë dhe zgjerimin e numrit të emigrantëve të kthyer që janë mbështetur nga shoqata.

Gjatë viteve 2001-2002 shoqata u mbështet nga **SDC** (Agjencia Zvicerane e Kooperimit dhe Zhvillimit) me qendër në Bernë. Kontributi i SDC-së ka qenë në funksion të projektit “Kape të Ardhmen”. Në vitin 2003, një donator i ri pranoi të mbështesë shoqatën. Mbështetja e **EED** (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjelike Gjermane) shënoi dhe zgjerimin e target grupit të shoqatës, e cila nga 2003 ka ndihmuar të kthyerit nga Gjermania dhe migrantët e brendshëm.

IOM Tirana është një tjetër bashkëpunëtor dhe financues i Shpresë për të Ardhmen. Programi VARRP është i bazuar pjesërisht në konceptin e rintegritimit ekonomik të emigrantëve të kthyer. Shpresë është përfshirë gjithashtu në një tjetër projekt të IOM të financuar nga KE (projekti GPNL). Deri më sot bashkëpunimi me IOM Tiranën ka qenë mëse i kënaqshëm dhe treguesi më

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

i mirë për këtë është vazhdimi i projektit deri në ditët e sotme nëpërmjet rinovimit të kontratave njëvjeçare.

Komisioni Evropian ka qenë financues i disa projekteve ku Shpresë për të Ardhmen është përfshirë. Mbështetja e tyre ka filluar me projektet ALNIMA dhe High Level Working Group dhe po vazhdon me projektin e ri ALBAMAR në kuadrin e Programit AENEAS dhe Projekti MIGRAVALUE në kuadrin e Programit INTERREG IIIB CADSES.

5. Kontributi i shoqatës në integrimin e emigrantëve të kthyer

Në një kontekst si ai shqiptar, ku kthimi është kthyer në një fenomen që ka nxjerrë në pah nevojën e projekteve të riintegrimit ekonomik dhe social, kontributi i shoqatës është shumë i madh. Ai ka qenë i bazuar në projekte të shumta në funksion të misionit dhe objektivave të shoqatës.

5.1 Aktivitetet e shoqatës

Projektet e shoqatës janë të bazuara në një sërë aktiviteteve që synojnë riintegrimin ekonomik dhe shoqëror të të kthyerve forcërisht ose vullnetarisht dhe të migrantëve të brendshëm, si edhe sigurojnë suksesin dhe vazhdimësinë e misionit të saj. Pas përshkrimit të projekteve kryesore të shoqatës dhe donatorëve, vlen të bëjmë një analizë të të gjitha aktiviteteve të shoqatës gjatë projekteve të ndryshme, dhe impaktin e këtyre aktiviteteve në jetën e të kthyerve dhe migrantëve të brendshëm, për të vlerësuar në këtë mënyrë suksesin e punës së zhvilluar nga shoqata gjatë këtyre viteve.

Programi i riintegrimit përmban këto aktivitete:

Riintegrimi profesional i migrantëve ku përfshihen:

- mundësi për të mësuar një profesion pranë bizneseve të vogla ose të mesme për një periudhë nëntëmuajore;

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

- lehtësimit i punësimit;
- negociimi për kushtet e punës dhe të kontratës, si edhe mbështetja financiare për përfituesit;
- mbështetje financiare për ndjekje studimesh të larta;
- mbështetje financiare për kurse trainimi.

Riintegrimi shoqëror ku përfshihen:

- Seancat e dëgjimit dhe të këshillimit. Shoqata u jep mundësinë emigrantëve të flasin për gjendjen e tyre, problemet, shqetësimet dhe vështirësitë, duke u përpjekur t’ia lehtësojnë apo zgjidhin ato në mënyrë që emigranti të realizojë dhe riintegrim shoqëror.
- Shkrimi i historive të emigrantëve si një përpjekje për ta bërë përfituesin të rikujtojë të shkuarën, ta pranojë atë dhe në këtë mënyrë të shohë në të ardhmen për perspektiva të reja në vendin e lindjes.
- Aktivitetet “Shtëpi e Hapur” u kanë dhënë mundësinë emigrantëve të diskutojnë në grupe të mëdha çështjet e riintegrit duke mësuar nga eksperiencia e njëri-tjetrit.

Të gjitha aktivitetet e mësipërme dhe të tjera shpjegohen në detaje si më poshtë.

Këshillimi për karrierën

Shpresë për të Ardhmen mirëpret të gjithë emigrantët e kthyer që kanë dëgjuar për projektet e saj të riintegrit apo që i janë referuar shoqatës nga aktorë të tjerë, si zyrat rajonale të punësimit, IOM Tirana apo organizata të tjera joqeveritare, si edhe referimet nga persona privatë si emigrantë apo përfitues të projektit. Këta persona paraqesin të dhënat e tyre te shoqata, intervistohen nga punonjësit socialë dhe më pas bëhet vlerësimi nëse ata mund të përfitojnë nga projektet e shoqatës apo jo. Sidoqoftë, atyre u ofrohet konsulencë parësore në lidhje me nevojat individuale që mund të ketë personi që është paraqitur në zyrë.

Këshillimi bëhet përsa i përket dëshirave dhe synimeve të të kthyerve në përputhje me aftësitë dhe kualifikimet që ata kanë, ose duan të zhvillojnë. Klientëve u jepen të dhëna mbi tregun e punës dhe mundësitë e suksesit në këtë treg, si edhe u jepen këshilla dhe orientim specifik për ndërtimin e një karriere në Shqipëri.

Mësimi i një profesioni

Siç thamë më lart, në mënyrë që një individ të riintegrohet në jetën e vendit të tij ka nevojë për një punësim të vazhdueshëm dhe të paguar në mënyrë të kënaqshme. Një pjesë e madhe e kontigjentit të kontraktuar nga shoqata nuk kanë një profesion, i cili kërkohet në tregun e punës në Shqipëri, apo në rajonin e tyre, dhe për këtë arsye janë të detyruar të gjejnë një punë si dhe ku të

munden. Arsyet e mungesës së profesionit lidhen me periudhën e tranzicionit. Nëse kanë qenë në moshë madhore, me ndërrimin e regjimit një numër profesione dolën nga tregu duke e bërë eksperiencën e këtyre njerëzve të pavlefshme. Gjithsesi, shumica e tyre nuk kanë një profesion për shkak të faktit se janë larguar nga Shqipëria në moshë të vogël, apo kanë qenë shumë të varfër për të mësuar një profesion. Të mësuarit e një profesioni gjatë tranzicionit është vështirësuar dhe nga mbyllja e një sërë shkollash profesionale në zonat larg Tiranës apo qyteteve të mëdha, duke e bërë kështu gati të pamunduar për plot të rinj të përvetësojnë një profesion me të cilin të mund të kërkojnë punë në Shqipëri. Pavarësisht se disa prej tyre kanë jetuar jashtë për një periudhë të caktuar kohe, mungesa e një statusi të ligjshëm ka bërë që të punojnë në tregun e zi të punës, pa kualifikime dhe duke bërë punëra të përkohshme e duke kaluar nga një punë në tjetrën pa arritur të përvetësojnë ndonjë profesion. Këtu mund të përmendim se kontigjenti i përfshirë me krimin as që është përpjekur të mësojë ndonjë profesion dhe nëse nuk ka pasur një të tillë para largimit nga Shqipëria, atëherë eksperiencia në vend të huaj nuk i ka shtuar asgjë aftësive të tyre profesionale.

Për rrjedhojë, kontrata 9-mujore që lidhin me shoqatën dhe një punëdhënës, u jep atyre mundësinë të mësojnë një profesion, gjë për të cilën është menduar se në kushtet e përmendura më lart një periudhë minimale prej nëntë muajsh është mëse e domosdoshme. Pra, personat në bashkëpunim me agjentin e punësimit të shoqatës kontaktojnë një punëdhënës, me të cilin firmoset një kontratë: për personat që zotërojnë një profesion firmoset një kontratë punësimi, ndërsa për të tjerët një kontratë për mësim profesioni, sipas së cilës punëdhënësi duhet t’i mësojë profesionin klientit të shoqatës. Sipas marrëveshjes së bërë me punëdhënësin, në fillimet e veta shoqata paguante 60% të pagës, ndërsa punëdhënësi 40%. Kjo bëhej me qëllim që të joshë punëdhënësi për ta marrë klientin në punë dhe për t’ia mësuar atij zanatin, përndryshe do të ishte e vështirë në kushtet e atëhershme ta detyroje atë të vepronte kështu. Më vonë shoqatës iu desh ta rishikonte këtë gjë, sepse ajo e ardhur që mund të konsiderohej e mjaftueshme në vitin 2000-2002 nuk është e mjaftueshme sot, pra tani shoqata nuk ndikon më te vullneti i punëdhënësit për t’i dhënë klientit atë që meriton në bazë të punës. Pra, duke marrë gjithashtu parasysh fondet në dispozicion është rënë dakort t’i jepet një suplement page me shumën prej 10.000 lekësh në muaj për projektin “Kape” dhe 15.000 lekë për përfituesit e VARRP-it, pavarësisht nga rroga që u ofron punëdhënësi.

Në këtë mënyrë edhe punëdhënësi ka një arsye më shumë për të punësuar dhe mbajtur në punë klientin e shoqatës, ndërkohë që dhe ky i fundit përfiton pasi në radhë të parë arrin të punësohet dhe të nxjerrë të ardhura për veten dhe familjen e vet dhe së dyti i jepet mundësia të mësojë një profesion, që kërkohet në tregun e punës në Shqipëri, ku ai/ajo jeton. Klienti arrin të mësojë detajet e

përditshme të profesionit, duke u specializuar në të duke punuar. Për më tepër, fakti që shoqata dëshmon për afro 80% të rasteve, që janë mbajtur në punë pas përfundimit të kontratës me shoqatën, tregon se edhe punëdhënësi shqiptar ka qenë i kënaqur me përparimin e klientëve të shoqatës, duke vendosur t'i mbajë në punë dhe t'u paguajë atë pjesë të pagës, e cila subvencionohet nga shoqata gjatë nëntë muajve të parë. Ky tregues është mjaft bindës përse i përket efikasitetit të metodës së përdorur.

Kjo metodë ka qenë vërtet më efiçasja ndër të tjera, duke qenë se kurset e formimit profesional të ofruara nga Qendrat e Formimit Profesional shtetërore janë të papajisura si duhet me bazë materiale dhe didaktike dhe funksionojnë në bazë grupesh (ato punojnë kur formohen grupe) si edhe nuk ofrojnë shumëllojshmëri kursesh. Për më tepër ato veprojnë në disa qytete të mëdha dhe jo në të gjithë territorin e vendit.

Lehtësimi i punësimit

Mësimi i profesionit shkon krahas me lehtësimin e punësimit sipas formatit të përdorur nga shoqata, sepse firmosja e kontratës për subvencionim të rrogës, nënkupton një gatishmëri më të madhe nga ana e punëdhënësve për të punësuar klientët e shoqatës, të cilët edhe pse punojnë me kohë të plotë, i paguajnë me rrogë të pjesshme.

Por lehtësimi i punësimit nuk duhet kuptuar vetëm në kuadrin e ndihmën ekonomike. Përfshirja me kontratën përbën një hap konkret nga ana e emigrantëve të kthyer për t'u integruar në tregun e punës në Shqipëri. Ky hap çon në hulumtimin e tregut të punës, njohjes së tij dhe përshtatjes me të. Agjenti i punësimit dhe pikat e kontaktit të shoqatës japin ndihmesën e tyre të drejtpërdrejtë me sugjerime për vende pune, duke përdorur të gjitha format, siç janë ofertat e punësimit nga zyrat rajonale të punësimit në Tiranë e Shkodër, informacionet nga publikimet e ndryshme si gazeta Çelsi, Biznesi, burime private informacioni etj. Shoqata harton një database me ofertat e punës çka lehtëson punën e saj në vendosjen e klientëve në tregun e punës.

Negocimi për kushtet e punës dhe të kontratës

Shumica e emigrantëve kanë qëndruar për një kohë të konsiderueshme në një vend të Evropës Perëndimore dhe janë mësuar me rregullin dhe formën kontraktuale të punësimit. Në kushtet e një Shqipërie, kur punësimi informal zë një përqindje të konsiderueshme (rreth 29% sipas burimeve të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta), pasja e një pune me kontratë ofron një farë garancie për klientët e shoqatës, si edhe një punë të sigurtë për një periudhë prej 9 muajsh. Ndërhyrja e shoqatës në këtë proces ka bërë të mundur ofrimin e garancisë për kushte të kënaqshme pune dhe për respektim të klientit nga njëra anë, dhe seriozitet në punë nga ana e klientit.

Mbështetja financiare për ndjekjen e studimeve të larta

Shoqatës i janë afruar edhe individë, të cilët pasi janë kthyer nga jashtë kanë kërkuar të ndjekim studimet në nivel universitar. Për këta njerëz është ofruar mbështetje financiare duke iu paguar tarifën e regjistrimit, në rastin e shkollës së lartë me kohë të pjesëshme, ose iu është ofruar ndihma e përmuajshme si atyre që mësojnë një profesion, por këtë rradhë mbështetja është dhënë në mënyrë që përfituesit të mund të përballojnë shpenzimet e vitit të parë akademik. Kjo mbështetje është dhënë me qëllim që të nxitet kualifikimi i të kthyerve, por edhe sepse të shkuarit në shkollë do të thotë një impenjim disaveçar, i cili ndihmon dhe në integrimin shoqëror të të kthyerve. Shoqata e sheh si një gjë mjaft pozitive integrimin e të rinjve me nivele të ndryshme edukimi, ata mund të mësojnë dhe përfitojnë më shumë nga eksperiencat dhe dijet e njëri-tjetrit dhe aktivitetet shoqërore kësisoj dalin më të gjalla dhe më interesante.

Mbështetja financiare për kurset e trajnimit

Disa prej të kthyerve kanë aftësi, të cilat ata mund t’i përdorin për të gjetur një punë në Shqipëri, por ndërkohë nuk plotësojnë disa kushte si ai i patentës, apo i njohjes së kompjuterit, si edhe i zotërimit të mjaftueshëm të një gjuhe të huaj. Shoqata u ka ofruar individëve të ndryshëm, nga projekte të ndryshme si “Kape të Ardhmen” apo “Hidhe Hapin” ndjekjen e një kursi trajnimi, ku individëve të ndryshëm u është ofruar pagesa për kursin e patentës, për një kurs kompjuteri të thjeshtë apo programesh specifike, për kurse të gjuhës së huaj, të cilat klientët i kanë parë si të domosdoshme për punësimin e tyre. Nëse vendet e punës gjenden nga përpjekjet e përbashkëta midis agentit dhe vetë klientëve, kurset e formimit profesional përzgjidhen dhe propozohen nga punonjëset sociale dhe agjenti i punësimit, të cilët kërkojnë me kujdes ato kurse që ofrojnë atë që kërkojnë klientët me çmime të arsyeshme. Këto kurse gjithashtu kanë qenë shumë të dobishme, dhe disa prej përfituesve kanë kaluar nga njëri nivel në tjetrin, duke avancuar dukshëm në njohuritë e tyre, gjë që më pas i ka ndihmuar për të gjetur një punë më të mirë.

Hapja e një minibiznesi

Në vitin e tretë të veprimtarisë, Shpresë për të Ardhmen synoi të ofronte shërbime të reja, që do të ishin një garanci më shumë për një kthim dhe riintegrim të qendrueshëm të emigrantëve të kthyer. Për këtë arsye iu dha mundësia disa klientëve të formonin një grup, të aplikonin dhe të fitonin mbështetje financiare.

Këto shërbime u ofruan për katër grupe dhe një individ, por vetëm njëri grup vazhdon aktivitetin edhe sot. Format i këtij aktiviteti nënkuptonte dhënieën e një shume prej 6.000 -10000 dollarësh (varej nga lloji i biznesit dhe përbërja e grupit), nga të cilat 2000-3000 në formë granti dhe të tjerat me të drejtë

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

kthimi me këste prej 100-200 dollarësh në muaj pa interes për një periudhë prej 3 vjetësh. Ky aktivitet nuk pati suksesin e pritur, dhe personat përfitues i shkelën kushtet e kontratës. Ata e ndërprejnë aktivitetin dhe, përveç një shume të vogël, nuk arritën të kthenin detyrimin. Ndërkohë që grupi i katërt, hapi një zdrukhtari të quajtur “Kape të Ardhmen” dhe që vazhdon edhe sot, edhe pse nuk ishte në gjendje t’i paguante detyrimet financiare ndaj shoqatës.

Arsyet objektive dhe subjektive të dështimit të kësaj iniciative janë disa. Në vitin 2002 kur shërbimi u ofrua për herë të parë, Shqipëria ka pasur mungesa të theksuara të energjisë elektrike me orare të zgjatura, gjë që çoi në ngadalësimin në mos ndërprerjen e shumë aktiviteteve private. Përveç kësaj, personat që aplikuan dhe u mbështetën nga projekti nuk kishin as njohuri bazë për të hapur një biznes dhe jo më për ta mbajtur atë, kishin mungesa në njohuri dhe vështirësi në marketing, si edhe mungesa në përvoja të ngjashme. Mungesa e përvojës bëri që ata të ishin skeptikë për vetë ecurinë e projekteve të tyre, pasi prisnin fitime të mëdha që në hapat e para të biznesit dhe mungesa e këtyre fitimeve bëri që ata ta braktisnin iniciativën. Në atë kohë shoqata arriti t’u siguronte huanë, por pa i pajisur me ekspertizën e duhur sipërmarrësit e këtyre bizneseve të vogla.

Si rrjedhojë, u pa e arsyeshme që të ndërpritej ky aktivitet që u konsiderua me rrezik të madh dhe të rimerrej në konsideratë si diçka e dobishme, por që duhej nisur nga organizimi i seminareve të trajnimit që do t’i mësonin këta të rinj si të zhvillonin një biznes. Edhe sot e kësaj dite ka shumë syresh që aplikojnë të marrin financime prej shoqatës, por nga e njëjta pikë nisjeje, çka është konsideruar se përmban elementë të rrezikut si në eksperiencat e lartpërmendura. Në përpjekje për të gjetur format dhe mundësitë më optimale për ta riaktivizuar këtë shërbim, u mendua që në përfundim të muajit të pestë të kryhej një anketim për të mbledhur informacion në lidhje me:

- Vijueshmërinë e kursit të formimit profesional
- Dëshirën e klientit për t’u përfshirë në një projekt minibiznesi
- Njohuritë që zotëron klienti mbi administrimin e një minibiznesi.

Më pas informacioni i grumbulluar u përpunua dhe mbi të u ngritën çështjet që do të përbënin programin e seminareve, si edhe u zgjodhën klientët që do të përfshiheshin duke marrë pjesë në këto seminare. Këtu u morën parasysh kriteret e tilla si dëshira për të filluar një minibiznes, aftësitë profesionale të fituara gjatë kursit 9-mujor, si edhe kriteret dytësore si mosha, arsimimi, niveli ekonomik, statusi civil etj.

Shoqata ka organizuar disa seminare në bashkëpunim me Partnerin Shqiptar në Mikrokredi dhe Tauleda (Agjencia Rajonale e Biznesit Durrës) ku klientët ja-

në ftuar të marrin pjesë dhe të mësojnë si të hapin një biznes, si të kërkojnë dhe ku të kërkojnë kredi, si të shkruajnë një curriculum vitae, si edhe të përgatiten për një intervistë pune. Të gjitha këto kanë qenë mjaft të frytshme. Të kthyerit i kanë ndjekur me interes dhe janë përpjekur të përfitojnë sa më shumë prej tyre. Pjesëmarrësve në seminare u janë shpërndarë dhe fletëpalosje dhe libra mbi biznesin (“ABC-ja e ndërmarrjes”, “Si të rritësh shitjet” të cilët u siguruan me ndihmën e TAULEDA dhe PSHM). Po kështu, ata janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në workshopet e organizuar nga IOM Tirana në kuadrin e hartimit të dokumentit politik për ndërtimin e kapaciteteve të zyrave rajonale të punësimin për riintegrimin e emigrantëve të kthyer, që u mbajt në maj 2006. Klientët jo vetëm që i kanë ndjekur aktivitete të tilla, por kanë dhënë dhe kontributin e tyre duke folur për eksperiencën e vet, dhe duke dhënë rekomandime e sugjerime për t’u ardhur sa më shumë në ndihmë personave në pozitat e tyre të mëparshme.

Pas një analize të thellë të situatës dhe eksperiencave të para, në kuadrin e zhvillimit të minibiznesit sot Shoqata “Shpresë për të Ardhmen” synon të mbështesë klientët e saj me:

- Seminare trajnimi

Të vazhdojnë të organizohen seminare trajnimi ku biznesmenëve t’u jepet informacion mbi tregun dhe mekanizmat e tij, biznesin që ata përfaqësojnë; të trajnohen se si të menaxhojnë biznesin e tyre në mënyrë që të jenë sa më të suksesshëm. Këto trajnime do të synojnë të ofrojnë jo vetëm njohuri teorike, por gjithashtu edhe njohje praktike. Për këtë arsye seminarët do të jenë të alternuara me vizita në biznese të ndryshme.

- Shkëmbim eksperience

Të mundësohen vizita në bizneset e së njëjtës fushë me qëllim shkëmbim eksperience.

- Ekspertizë

Të sigurohet ekspertizë nga specialistë të fushës përkatëse për të mësuar, përmirësuar dhe monitoruar minibizneset ekzistuese.

- Blerja e veglave të punës

Bizneset e vogla të ndihmohen të blejnë makineri pune, ndoshta edhe të përdorura. Procesi i blerjes së makinerive (të reja ose të përdorura) duhet të realizohet në bashkëpunim me biznesin i cili duhet të sigurojë një pjesë të kostos financiare. Në këtë kuadër mund të realizohet bashkëpunimi me biznesin e madh. Makineritë të cilat nuk do të përdoren më nga biznesi i madh dhe janë në gjendje të mirë pune, t’i kalohen biznesit të vogël kundrejt një vlere monetare të arsyeshme.

Ndihma për blerjen e mjeteve të punës

Një formë tjetër që shoqata ka përdorur me efikasitet për riintegrimin ekonomik të klientëve të vet është blerja e mjeteve të punës për hapjen e një minibiznesi. Persona nga projekte të ndryshme që kanë ndjekur kurse trainimi, apo kanë mësuar një profesion për nëntë muaj, kanë shprehur dëshirën për të punuar më vete, dhe shoqata i ka ndihmuar me blerjen e një mjeti të rëndësishëm pune, si psh frezë për një drugdhendës në Berat, apo makina qepëse për një kliente të Tiranës, pajisjet për hapjen e një lavazhi makinash si edhe perspektiva për të blerë makina të tjera qepëse për gratë më të përgatitura e të përkushtuara në Laknas.

Në kushtet e të ardhurave të pakta, por dëshirës së madhe për të punuar dhe për t'u integruar në tregun e punës, dhënia e kësaj ndihmese modeste bëhet shumë e rëndësishme, pasi hap një dritë jeshile në kuadrin e punësimit të qëndrueshëm dhe të ardhurave të vazhdueshme, duke rezultuar në riintegrim të qëndrueshëm. Të gjitha rastet e intervistuara, tregojnë se kjo ndihmë ka qenë vendimtare në jetën e tyre, pasi erdhi në momentin e duhur, pas mësimit të profesionit dhe shërbeu si një pikënisje e fuqishme për ndërtimin e jetës së tyre në vend dhe një të ardhme financiarisht më të mirë.

Takimet "Shtëpi e Hapur" me klientët/përfituesit e projektit

Takimet "Shtëpi e Hapur" zhvillohen në mënyrë periodike, më shpesh në Tiranë dhe pak më rrallë në rrethe. Këto takime janë organizuar për t'u dhënë mundësinë të rinjve të takohen me njëri-tjetrin dhe të bisedojnë për gjendjen e tyre, kushtet në të cilat kanë ikur dhe janë kthyer, si edhe për përfshirjen e tyre në aktivitetin e shoqatës, si një formë për të lehtësuar riintegrimin e tyre shoqëror në Shqipëri. Përveç bisedave të lira, që synojnë krijimin e miqësive të reja, gjatë këtyre takimeve zhvillohen dhe diskutime rreth temave të paracaktuara, sipas një kalendarit të hartuar nga punonjësja sociale. Disa nga temat e diskutuara kanë qenë rinia dhe droga, problemet e shoqërisë shqiptare, raportet midis gruas dhe burrit në shoqërinë shqiptare apo njohja dhe mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme. Qëllimi i diskutimeve të kësaj natyre është ndërgjegjësimi i të rinjve për çështje të ndryshme bashkëkohore dhe përfshirja e tyre në rrjedhën e jetës shoqërore të vendit të tyre, duke bërë që të mos ndihen si të përjashtuar apo jashtë kontekstit.

Takimet "Shtëpi e Hapur" janë shfrytëzuar edhe për të afruar biznesmenët e vegjël e të mesëm që kanë punësuar klientët e shoqatës.

Shkëmbimi i informacionit me trajnerët

Dimensioni i dytë që u shtua në vitin e tretë të aktivitetit kishte të bënte me afrimin e trajnuesve të klientëve me njëri-tjetrin dhe në të njëjtën kohë me shoqatën, në mënyrë që të identifikoheshin nevojat dhe të mundësohej trajnimi i përshtatshëm për ta. Kjo do t'i bënte ata më të aftë që t'i ofronin trainimin e

duhur klientëve të Shpresë për të Ardhmen, konkurues për tregun e punës në Shqipëri. Ky qëllim është realizuar nëpërmjet aktivitetit të “Shtëpisë së Hapur”, të zhvilluar me pjesëmarrjen e sipërmarrësve të ndryshëm me të cilët shoqata ka bashkëpunuar, gjatë të cilave është mundësuar shkëmbimi i informacionit me specialistët e shoqatës. Këto takime nuk patën rezultatin që shpresohet, sepse shoqata nuk ishte në gjendje të ofronte mundësi konkrete për zhvillimin e biznesit të tyre. Ata kërkonin makineri dhe ndërmjetësim pranë bizneseve në Zvicër për të realizuar vizita dhe për të pasur shkëmbim eksperience me biznesmenët zviceranë. Dëshira e tyre ishte që të blinin makineri të përdorura, por në gjendje të mirë pune. Shoqata nuk ishte në gjendje të ndërmernte hapa të tillë, kështu që këto takime nuk patën jetë të gjatë.

Aktivitetet kulturore e sportive

Aktivitetet kulturore nënkuptojnë vizita në vende turistike apo historike si Kruja, vajtje kolektive në kinema apo stadium, mbledhje dhe organizim festimesh të ndryshme. Përveç kësaj shoqata ka organizuar edhe ndeshje futbollit apo dhënien e çmimit për historinë më të mirë të shkruar nga të rinjtë e përfshirë në projekt.

Dëshira e të rinjve për t’u përfshirë në këto aktivitete ka qenë e madhe dhe pjesëmarrja e mirë. Ka nga ata që janë larguar që gjatë adoleshencës, që do të thotë se nuk kanë pasur mundësi të jetojnë moshën e tyre dhe sot kanë probleme me integrimin shoqëror. Këto aktivitete janë shumë të mira sepse në mjedise ku ata mund të mësojnë dhe argëtohen, në të njëjtën kohë mund të zhvillojnë dhe shoqëri e miqësi, duke u integruar edhe në këtë aspekt shoqëror në Shqipëri.

Vizitat vëzhguese të donatorëve

Një nga aktivitetet e rregullta të shoqatës është edhe organizimi i vizitave vëzhguese të donatorëve. Këto vizita në grupe organizohen herë pas here. Donatorë të projektit “Kape të ardhmen” si edhe persona të tjerë që kanë qenë donatorë potencialë, si edhe studentë apo gazetarë të interesuar mbi punën e shoqatës janë ftuar nga shoqata dhe nga themeluesi i saj De Mestral të vizitojnë Shqipërinë. Gjatë këtyre vizitave të ftuarve u është dhënë mundësia të shikojnë punën e shoqatës nga afër, të takohen me përfituesit e projektit, si edhe të njihen me Shqipërinë. Vizitat nuk kanë qenë të përqendruara në Tiranë, por edhe në rrethe të tjera, por më tepër në qytete që rezultojnë me një numër të madh të kthyerish, dhe që kanë nevojë për ndërhyrje e zhvillim ekonomik në mënyrë që të parandalohen fenomene shqetësuese si emigrimi i paligjshëm, por edhe për të garantuar një kthim të qëndrueshëm. Vizitat pra kanë shërbyer si një mënyrë për të njohur investuesit potencialë zviceranë me mundësitë që ofron Shqipëria dhe krahu i punës në Shqipëri.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

Përmbledhtazi, aktiviteti i vizitës përfshin njohjen me shoqatën, me punën e përditshme të saj, me klientët e saj dhe vendet nga vijnë ata. Vizitorët janë takuar edhe me përfaqësues të organizatave të tjera që merren me emigrantët e rikthyer si IOM Tirana, apo janë përfshirë në takimet e Shtëpisë së Hapur, si edhe në aktivitetet me të rinjtë, gjatë të cilave është vazhduar misioni sensibilizues për rreziqet e emigrimit dhe qëndrimin të paligjshëm në vende si Zvicra. Më pas bëhet një vlerësim i punës, që i ka shërbyer shoqatës si mënyra për të qenë transparente me donatorët, në mënyrë që të rikonfirmohet mbështetja e tyre, si edhe për të tërhequr fonde të reja për shoqatën dhe investime për Shqipërinë. Në raste të veçanta, si në aktivitetin e tetorit 2004, vizitorët përgatitën një broshurë (Albanien: Kape të Ardhmen, Im Land der Skipetaren) me fotografi nga vizita e tyre, si edhe me informacion mbi Shqipërinë, shqiptarët dhe shoqatën. Ky botim synonte të tërhiqte vëmendjen e atyre personave që mund të shfaqnin ose kishin shfaqur interes për Shqipërinë dhe për projektin e shoqatës, dhe që mund të bindeshin për t’i mbështetur financiarisht ato. Në këtë formë këta njerëz përcjellin informacione për shoqatën në Zvicër dhe, së bashku me Patrice de Mestral përpiquen në mënyrë të vazhdueshme të thithin fonde për aktivitetin e shoqatës.

Takimet ndërgjegjëse mbi migracionin me të rinjtë

Përveç aktiviteteve që synojnë riintegrimin profesional dhe shoqëror të emigrantëve të kthyer, shoqata ka si synim dhe e ka vendosur dhe në statutin e vet parandalimin e fenomenit të emigrimit, sidomos emigrimit të paligjshëm, i cili e shtyn rininë në rrugën e gabuar të kimit. Për arritjen e këtij qëllimi janë organizuar takime ndërgjegjëse me të rinjtë e shkollave të mesme, ku punonjësit e shoqatës kanë prezantuar shoqatën tek të rinjtë dhe kanë biseduar me ta rreth emigrimit. Aktivitete të tilla janë organizuar disa herë dhe shoqata ka ftuar edhe klientë të vetët që të bisedojnë me të rinjtë në lidhje me eksperiencën e tyre në emigrim. Për më tepër, kur nisi këtë aktivitet shoqata bashkëpunoi me një organizatë rinore të quajtur RIART, e cila realizoi krijimin e një fumeti me temë nga migracioni shqiptar.

RIART është një organizatë, anëtarët e së cilës janë artistë që organizojnë aktivitete rinore artistike të cilat synojnë përfshirjen aktive të rinisë në shoqëri. Në projektin e tyre në bashkëpunim me Shpresë për të Ardhmen, fumeti me temë emigracionin shtjellon në 46 faqe historitë e të rinjve të sotëm, atë çka i shtyn drejt rrezikut të emigrimit të parregullt, si edhe realitetin e atyre që emigrojnë. Në këtë fumet përveç historisë së shoqëruar me figura, janë vendosur dhe informacione mbi vetë RIART, por edhe mbi Shpresë për të Ardhmen. Në fund të tij, gjendet një anketë, me anë të së cilës shoqata përpiket të kuptojë qëndrimin e të rinjve ndaj emigracionit, arsyet për këtë qëndrim, vendi ku do të donin të emigronin, arsyet, dhe midis të tjerave u kërkohet të shprehin mendimin e tyre mbi të ardhmen e Shqipërisë dhe lidhjes që ekziston

midis saj dhe emigrimit. Ky fumet është shpërndarë nëpër shkolla të mesme, dhe është dhënë gjatë aktiviteteve sensibilizuese me të rinjtë për rreziqet dhe padobishmërinë e emigrimit të parregullt.

Kjo formë ndërgjegjësimi ka qenë mjaft efikase, sepse përdor një mjet të përshtatshëm dhe të kuptueshëm nga të rinjtë e asaj moshe, pa ua paraqitur realitetin në mënyrë agresive, por nëpërmjet pasqyrimin të situatave konkrete që ata i kanë jetuar ose njohur nga afër. Për më tej, ai është një material i cili mund të merret në shtëpi dhe të lexohet nga të rinj të tjerë apo njerëz të njohur të pjesëmarrësit në një nga takimet sensibilizuese, pa dhënë përshtypjen e moralizimit të tepërt, që për këto mosha mund të ketë dhe efektin e kundërt. Fumeti është i këndshëm, interesant, tërheqës dhe realist dhe për këto arsye ka qenë një nga format më të suksesshme të ndërgjegjësimin të rinisë gjatë aktiviteteve me shkollat e mesme.

Deri tani takimet dhe biseda me të rinjtë është zhvilluar në shkollën e mesme të përgjithshme “Sami Frashëri” dhe “Petro Nini Luarasi” në Tiranë, “Kristaq Capo” dhe “Babë Dudë Karbunara” në Berat, si edhe në liceun artistik “Prenkë Jakova” në Shkodër. Përveç bisedës me të rinjtë dhe takimit me të kthyer, atyre u janë shpërndarë kopje të fumetit dhe iu është kërkuar plotësimi i anketës në fund të tij. Kampioni u përzgjedh brenda grup-moshave 15 deri në 18 vjeç. Të pyetur për një epitet për emigracionin vetëm 24.93% dhanë një mendim pozitiv, ndërkohë që 61.19% dhanë mendim negativ dhe rreth 13.88% as pozitiv dhe as negativ. Vetëm 11.9% prej tyre kishin emigruar më parë, por 47.88% do të emigronin nëse do t’iu jepej mundësia, ndërkohë që 43.91% e tyre mendojnë se familja do t’i mbështeste në qëllimet e tyre për emigrim. Pavarësisht nga kjo, vetëm 17% do të zgjidhnin emigrimin përkundrejt shkollimit në Shqipëri, duke reflektuar mbi ndërgjegjësimin e rinisë shqiptare se arsimit i lartë është më i rëndësishëm dhe i lakmueshëm sesa emigrimi ekonomik. Shumica e të rinjve (88.95%) besojnë se pakësimi i emigracionit ka ardhur si pasojë e rritjes së gjendjes ekonomike në vend, duke dëshmuar kështu për një këndvështrim pozitiv përse i përket të ardhmes së tyre në vendlindje. Gjithsesi, rreth 68.56% prej tyre ende besojnë se progresi i Shqipërisë do të jetë i lidhur me emigracionin. (Të dhënat e plota të anketës dhe tabela përmbledhëse janë paraqitur në shtojcën 2.)

Këto të dhëna dëshmojnë se edhe pse mendimi negativ mbi migracionin dominon dhe se të rinjtë shqiptarë mendojnë se e ardhmja në vend nuk është më aq e dëshpëruar sa gjatë viteve 1990-të, përsëri një numër i konsiderueshëm prej tyre kërkon të emigrojë duke menduar se familja do ta mbështeste këtë veprim. Gjithsesi, emigrimi mbetet një alternativë dytësore, që merret në konsideratë vetëm pas vazhdimin të shkollës së lartë. Shqetësues mbetet fakti që një përqindje kaq e lartë të rinjsh (68.56%) mendojnë se përparimi i Shqipërisë dhe përmirësimi i jetës në vend vazhdon të varet nga emigracioni

dhe të ardhurat e tij, gjë që na shtyn të mendojmë se konsiderohet ende si një rrugëzgjdhje e mirë për ngritjen e standardit të jetesës në Shqipëri.

5.2 Grupi i të rikthyerve forcërisht.

Kur lindi projekti “Kape të Ardhmen”, ai u projektua për të ndihmuar pikërisht atë grup njerëzish që ndaleshin nga policia zvicerane dhe pas një periudhe disa javore ose vjeçare në burgjet e Zvicrës, ktheheshin në Shqipëri nga autoritetet e vendit. Ky grup është parë si më i vështiri për riintegrim ngaqë në vendet pritëse si Zvicra kanë qenë të përfshirë me krimin, falë të cilit shumë syresh kanë bërë një jetë luksoze dhe pa shumë mundime për të punuar. Kjo jetë bie në një kontrast edhe më të madh me të jetuarin në Shqipëri, ku njerëzve u mungon një punë e qëndrueshme dhe e paguar mirë, dhe të kthyerit e gjejnë veten në pikën fillestare të para emigrimit kur ata ishin të varfër dhe pa asnjë mundësi. Për më tepër, pas kthimit ata edhe pse kanë pasur peripeci me ligjin në Zvicër, e shohin shumë të vështirë kthimin në punë me rrogat minimale që ofrohen në Shqipëri. Përveç kësaj, e shkuara e tyre e lidhur me krimin bën që ata të shihen me dyshim nga punëdhënësit e mundshëm duke pakësuar kështu mundësitë për punësim dhe integrim në jetën e komunitetit ku janë kthyer. Për këtë arsye ndërhyrja e Shpresë për të Ardhmen është parë si diçka pozitive, e cila ka ndryshuar jetën e këtyre njerëzve në shumë aspekte.

Kontakti i parë

Me disa syresh kontakti i parë është kryer që në Zvicër. Duke qenë të burgosur atje ka qenë dhe më e lehtë për shoqatën për t’i kontaktuar dhe për të folur me ta në lidhje me shërbimet që do t’u ofrohen kur të vijnë në Shqipëri. Vetë De Mestral ka qenë i pari, i cili duke shkuar nëpër burgje e duke folur me këta të rinj, u ka treguar atyre për projektin “Kape të Ardhmen” dhe për mundësinë e bashkëpunimit me ta në kthim si një mënyrë për të lehtësuar qëndrimin. Përveç bisedave me De Mestral, shoqata ka bërë vizita në burgjet e Zvicrës, ku përsëri janë takuar dhe kanë biseduar me të rinjtë shqiptarë atje. Ndërkohë një grup edhe më i madh njerëzish janë arritur nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe broshurave të tjera orientuese, si edhe nëpërmjet kontakteve të shoqatës në Tiranë. Forma e tretë me të cilën shoqata ka arritur deri tek përfituesit në vendin pritës ka qenë ajo mediatike. Në 2001 shoqata ka realizuar një dokumentar, i cili është transmetuar jo vetëm në Tiranë, por edhe nëpër burgje, ku të rinjve iu është treguar rreth mundësive që ofron Shqipëria, si edhe shërbimet e shoqatës në bazë të shembujve konkretë bashkëpunimi me të kthyerit nga Zvicra. Gjithashtu vizitorë të shoqatës apo dhe njerëz të tjerë kanë shkruar në median zvicerane rreth projektit “Kape të Ardhmen” dhe shoqatës “Shpresë për të Ardhmen” duke e përhapur dhe më tej misionin dhe punën e shoqatës për të arritur deri tek përfituesit potencialë.

Pavarësisht nga reklama që i është bërë punës së shoqatës, një pjesë e mirë e atyre që kanë dëgjuar për shoqatën në Zvicër kanë qenë skeptikë përse i përket mundësive reale dhe shërbimeve që ofron ajo. Mirëpo me kthimin në Shqipëri, pavarësisht nga skepticizmi ata kanë ardhur në dyert e shoqatës dhe kanë parë nga afër se ç’mund t’u ofrohej. Në fillimet e veta, dyshimi për qëllimet e shoqatës ishin dhe më të mëdha, sidomos kur shtohesh se ajo financohej nga burime zvicerane dhe shumë prej tyre nuk arrinin të kuptonin se pse ndërsa i kthenin nga Zvicra me forcë, zviceranët përpiqeshin t’i ndihmonin. Të tjerë mendonin se nëpërmjet shoqatës do të mund të rekuperonin të ardhurat që kishin lënë apo që iu ishin sekuestruar në Zvicër. Kjo periudhë ka qenë shumë e vështirë për shoqatën, pasi i është dashur të shpjegojë qëllimet dhe objektivat e veta. Me kalimin e kohës, situata është lehtësuar, pasi vetë përfituesit e parë kanë qenë ata, të cilët kanë shërbyer si “zëdhënës” dhe reklamues të shoqatës. Vetë personeli ndihmës, që ka shërbyer si pika kontakti për Beratin, Shkodrën dhe Tiranën janë përzgjedhur nga grupi i të kthyerve, që janë përfshirë në projektin “Kape të Ardhmen”. Po kështu, nga intervistat e zhvilluara, pothuaj të gjithë kanë folur me të kthyer të tjerë për shoqatën, të cilët më pas kanë ardhur dhe kanë biseduar me stafin dhe disa prej tyre kanë qenë dhe përfitues të mëvonshëm.

Përfshirja në projektet e Shpresë për të Ardhmen

Ardhja në zyrat e shoqatës s’është vetëm se hapi i parë drejt bashkëpunimit midis shoqatës dhe këtij grupi përfituesish. Takimi me punonjësen sociale është shumë i rëndësishëm për fazat e tjera. Konfidencialiteti dhe garancia se do të trajtohen mirë është kryesore për këta njerëz, për këtë arsye trajtimi që iu bëhet nga ana e punonjësve socialë dhe pjesa tjetër e stafit është shumë i kujdesshëm. Vetë të gjithë të intervistuarit, midis tyre edhe ata të kthyer nga Zvicra flasin për një pritje shumë të mirë, të ngrohtë dhe miqësore. Ata reflektojnë gjithashtu mbi seriozitetin dhe korrektësinë e punonjësve të shoqatës, që së bashku me ndihmën konkrete të dhënë kanë bërë ndryshimin në jetën e tyre.

Të kthyerit nga Zvicra dhe Gjermania përfitojnë nga projekti “Kape të Ardhmen”. Me t’u kthyer nga Zvicra apo Gjermania, ata lidhen me shoqatën, qoftë nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet personave të kontaktit në Berat dhe Shkodër. Pas intervistës së parë, bëhet përzgjedhja e personave që do të përfitojnë nga shërbimet e shoqatës. Këto shërbime nënkuptojnë mësimin e një profesioni apo lehtësimin e punësimit gjatë një periudhe prej nëntë muajsh, ndërsa punojnë për një punëdhënës me kontratë, siç thamë dhe gjatë përshkrimit të projektit “Kape të Ardhmen”. Profesionet kryesore që kanë mësuar klientët e “Kape” janë zdruktartari, mekanikë, punëtorë ndërtimi, kuzhinierë, parukierë, rrobaqepës etj. Gjithsesi në programet e shoqatës janë përfshirë dhe njerëz që janë specializuar në përdorimin e programeve të sofistikuar kompjuteri. Me pak fjalë, janë mbështetur të gjitha profesionet, të cilat klientët kanë dashur të mësojnë, duke i ndihmuar ata në këtë mënyrë

të riintegrohen në shoqërinë shqiptare duke mësuar një profesion, i cili do t'i ofronte dhe u ka ofruar të kthyerve mundësi më të mëdha punësimi.

Ndërkohë, gjatë periudhës prej nëntë muajsh, shoqata monitoron rregullisht punën e klientëve të saj, duke i takuar personalisht çdo muaj për dhënien e pagës. Paga i jepet personit nëpërmjet pronarit dhe nuk mund ta marrë asnjë i afërm i personit. Si pronari ashtu edhe personi firmosin për marrjen e pagës. Kjo është bërë si një masë kontrolluese që personi është duke e ndjekur programin e mësimit të zanatit dhe nuk është larguar, por edhe për të biseduar me të çdo muaj për të mësuar rreth përparimeve që ka bërë, nëse ndihet mirë, nëse ndjen se po përfiton diçka, e gjëra të tjera si këto. Monitorimi bëhet dhe në mënyra të tjera. Një nga përfaqësuesit e shoqatës, zakonisht agjenti i punës, bën vizita në vendin e punës së klientit për të parë që ai/ajo shkon rregullisht në punë dhe bisedon me pronarët për ecurinë e të mësuarit të profesionit nga ana e klientit. Në rrethin e Beratit dhe Shkodrës monitorimi kryhet edhe nga pika e kontaktit, rolin e të cilit e kemi shpjeguar më lart.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe mbajtja e kontakteve të rregullta ka qenë një mënyrë shumë efiçente për të garantuar përfundimin me sukses të kontratave dhe realizimin e qëllimit të projektit, që është dhënia e mundësisë për të mësuar një profesion, apo lehtësimi i punësimit i cili nga ana e vet do të mundësojë riintegrimin e të kthyerve në vendet e tyre të banimit. Monitorimi gjithashtu ka bërë që të pakësohet mundësia e mashtrimit dhe e shkeljes së kontratave me synim arritjen e qëllimeve të shoqatës.

Përveç monitorimit nga ana e vijimësisë në punë, klienti është në kontakt dhe me punonjësen sociale, e cila është në gatishmëri për problemet që mund të ketë ai/ajo gjatë periudhës së formimit profesional dhe shpesh ato dhe i gjithë stafi i shoqatës i kanë ndihmuar klientët të zgjidhin dhe probleme vetjake që mund të kenë me shtetin nga i cili kanë ardhur, apo me institucionet shqiptare. Shoqata është munduar me anë të këshillave, dhënies së informacionit dhe referimit tek institucionet përkatëse t'ua lehtësojnë riintegrimin klientëve të vet.

Disa nga aplikuesit kanë ndjekur një formulë tjetër. Ata kanë preferuar të ndjekin një nga kurset e trajnimit për mësimin e programeve të kompjuterit, kurse të gjuhës së huaj ose për patentë, në mënyrë që të marrin disa aftësi për t'ua lehtësuar punësimin. Më pas, disa prej tyre kanë gjetur punë qoftë vetë, qoftë nëpërmjet programit të mësimit të profesionit të shoqatës, duke u përpjekur dhe këta të integrohen profesionalisht, njëlloj si të tjerët të përmendur më lart.

Dimensionin tjetër i marrëdhënies së shoqatës me klientët e vet është ai

shoqëror. Individët e trajtuar nga shoqata e kanë lënë Shqipërinë vite më parë dhe kanë probleme me riintegrimin shoqëror e kulturor në vend. Njerëzit dhe vendi kanë ndryshuar gjatë ikjes së tyre, edhe ata vetë kanë bërë eksperiencë, të cilat nuk i gjejnë tek njerëz të tjerë dhe për këtë arsye e kanë dhe më të vështirë përshtatjen. Me anë të aktiviteteve “Shtëpi e Hapur”, dhe festimeve në grup, konkursit për historisë më të mirë të emigrimit, ekskursioneve në Krujë, apo ndeshjet e futbollit midis klientëve, shoqata u ka krijuar mundësinë këtyre njerëzve të takohen me të tjerë njerëz, që ndajnë eksperiencë të njejta ose të ngjashme me ta, të flasin mes tyre dhe ta kuptojnë se nuk janë vetëm në fatin e tyre dhe kështu të arrijnë të bëjnë miq të rinj në këtë Shqipëri të ndryshuar. Po kështu, të folurit me njerëz që kanë kohë që janë kthyer u jep atyre shpresë se edhe ata do të arrijnë të integrohen dhe se nëse përpiqen ky kthim mund të jetë dhe më i lehtë dhe ata të mund të jetojnë në Shqipëri në kushte më të mira.

Gjatë intervistave vetë pjesëmarrësit u shprehën shumë të kënaqur nga fakti se iu ishte dhënë mundësia të merrnin pjesë në këto aktivitete shoqërore. Shumica prej tyre kishin marrë pjesë në të paktën një prej tyre, dhe të gjithë i identifikonin takimet si një mundësi shumë e mirë për t’u njohur me njerëz dhe për të mos u ndjerë dhe aq vetëm. Shkrimi i historisë së emigrimit gjithashtu është vlerësuar si pozitive, pasi kështu iu është dhënë mundësia për të folur për jetën e tyre, pa u gjykuar dhe duke e paraqitur sipas këndvështrimit personal, domethënë atyre iu është kërkuar që të flasin për eksperiencën e emigrimit të tyre. Fakti që është me shkrim u ka dhënë mundësinë të thonë gjëra të cilat nuk kanë dashur t’i flasin me gojë, ose që i kanë anashkaluar gjatë bisedës me punonjësen sociale. Në formën e një stimuli për klientët ka shërbyer edhe shpërndarja e çmimit të historisë më të mirë në fund të çdo viti dhe botimi i historive ose disa pjesëzave në botimin e shoqatës të titulluar “Shpresë”. Përpjekja më e madhe për t’u dhënë zë këtyre njerëzve dhe për t’i bërë publike historitë e tyre është botimi me titull “Në udhëkryqet e jetës”, i cili përmbledh shumë histori emigrimi dhe është botuar në dy gjuhë: shqip dhe gjermanisht duke u përpjekur të arrijë tek shqiptarët dhe tek të huajt, kryesisht zviceranët.

5.3 Grupi i të rikthyerve vullnetarë

Shpresë për të Ardhmen filloi të merrej me të kthyerit vullnetarë që në 2001, duke asistuar një numër të kufizuar syresh. Ky numër erdhi duke u shtuar kur financimet u zgjeruan me donatorë gjermanë si EED (Ndihma për Zhvillim e Kishës Evangjelike Gjermane), por sidomos nga partneriteti me IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) në kuadrin e projektit VARRP. Sipas ligjeve të vendeve si Gjermania apo Mbretëria e Bashkuara, personave që iu refuzohet qëndrimi në këto vende duhet të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës. Kontigjenti i tyre sa ka ardhur dhe është shtuar, duke

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

qenë se sa më shumë kalon koha, aq më shumë rritet bindja nga autoritetet e vendeve të Evropës së Bashkuar se shqiptarët mund të kthehen në vendin e tyre, pa rrezikuar asgjë. Në të njëjtin përfundim kanë arritur dhe një pjesë e këtyre emigrantëve, të cilët ose kanë mbetur të zhgënjyer nga eksperiencia në perëndim, ose nuk kanë arritur të integrohen dhe për këtë arsye kanë vendosur të kthehen në Shqipëri.

Në trajtimin që u ka bërë shoqata të kthyerve vullnetarë në krahasim me ata forcërisht nuk ka shumë ndryshim. Në kuadrin e projektit “Kape të Ardhmen” procedurat janë të njëjta. Vihet re se këta njerëz janë më të hapur dhe më të gatshëm për bashkëpunim sesa kontigjenti i parë, i cili siç thamë më lart janë më dyshues dhe më pak të predispozuar për të kërkuar ndihmë. Siç shprehen dhe punonjësit e shoqatës, të kthyerit vullnetarisht janë njerëz që janë mësuar me sistemin e ndihmës dhe asistencës në shtetet ku kanë qenë. Për ta është normale që një organizatë joqeveritare të përpiqet t’i ndihmojë, dhe për këtë arsye janë më pro-aktivë se të kthyerit forcërisht. Mes të intervistuarve, shohim se ata e kanë kërkuar vetë mundësinë për t’u ndihmuar dhe me të marrë informacionin për ekzistencën e shoqatës i janë afruar asaj dhe kanë ndjekur të gjitha procedurat për të përfituar nga programet e saj të mbështetjes për riintegrim ekonomik dhe social.

Përrjashtim në këtë grup bëjnë klientët e referuar nga programi VARRP i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, të cilët përfitojnë nga një mbështetje financiare prej afro 15000 lekësh në muaj për një periudhë njëvjeçare (sipas marrëveshjes së fundit me IOM) dhe ata mund të përfitojnë mbështetje vetëm për vendosjen në një vend pune. Edhe ata janë të përfshirë në aktivitetet sociale të shoqatës dhe janë ftuar në gjithë seminarët dhe workshopet që ka organizuar apo ka marrë pjesë shoqata. Pra, përveç diskriminimit pozitiv të shprehur në një pagesë 5000 lekë më të lartë se përfituesit e projektit “Kape të Ardhmen”, përfituesit nga IOM VARRP nuk janë diferencuar në trajtim nga ana e shoqatës.

Për shoqatën puna me grupin e të kthyerve vullnetarë ka qenë më e lehtë për faktin se këta njerëz janë kthyer me vullnetin e tyre të lirë. Ata kanë ardhur për të mos u larguar më dhe vetëm një zhgënjim tjetër i fortë me Shqipërinë, apo një situatë e jashtëzakonshme do t’i bënte të largoheshin përsëri. Fakti që janë kthyer me dëshirën e tyre do të thotë se ata kanë si synim riintegrimin në Shqipëri dhe do të bënin gjithçka për t’u përshtatur duke gjetur një punë dhe duke u ripërshtatur në shoqërinë shqiptare. Ky vullnet pozitiv dhe kjo gatishmëri për riintegrim bëjnë që ata të jenë më bashkëpunues ndaj ndihmës së ofruar nga shoqata. Në punën me ta, shoqata gjithashtu numëron një sërë suksesesh.

Gjithsesi, nuk duhet përjashtuar fakti se ka edhe syresh që ngelen të zhgënjyer nga realiteti i ri që gjejnë në Shqipëri dhe të pakënaqur rrahin sërish rrugën e migrimit.

5.4 Grupi i migrantëve të brendshëm.

Ndryshimi i regjimit pati një ndikim shumë të madh në shoqërinë shqiptare. Ai solli ndryshime në ekonomi, në formën e papunësisë dhe varfërisë, sidomos në zonat malore e rurale të vendit. Ky nivel i lartë papunësie e varfërie, së bashkë me kushtet e turbullta politike në të cilat është ndodhur Shqipëria këto 16 vitet e fundit bënë që shumë njerëz të shpërngulen nga banimet e tyre origjinale dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme, kryesisht në Durrës dhe Tiranë. Rrethi i Tiranës dhe në veçanti qyteti u zgjerua shumë, duke krijuar kështu zona të tëra joformale me banorët e ardhur nga gjithë Shqipëria, edhe pse grupi i të ardhurve nga veriu është më i madh se grupet e tjera.

Pasojat e këtyre lëvizjeve të pakontrolluara kanë qenë shqetësuese si në rrafshin ekonomik ashtu edhe atë social. Personat e shpërngulur u vendosën në tokat e dikujt tjetër duke shkaktuar një nga konfliktet më të mëdha të shoqërisë shqiptare këto vitet e fundit, atë të pronës. Informaliteti i këtyre zonave ka çuar në rizgjimin e fenomeneve si gjakmarrja apo edhe probleme shëndetsore e shoqërore të tjera që vijnë nga mungesa e shërbimeve dhe urbanizimit. Po kështu, ardhja në periferi të Tiranës nuk ka ndihmuar shumë në pakësimin e nivelit të varfërisë të këta njerëz, sikurse nuk ka ndihmuar në përmirësimin e nivelit të papunësisë.

Të gjitha këto kanë bërë që trajtimi i migrantëve të brendshëm të bëhet pjesë e objektivave të shoqatës që nga viti 2003. Deri në 2005 përfshirja e migrantëve të brendshëm ka qenë sporadike dhe vetëm me anë të projektit “Hidhe Hapin”, të përqendruar për momentin në fshatin e Laknasit në rrethin e Tiranës janë përmbushur disa nga synimet që i kanë vënë vetes. Duke pasur parasysh përqendrimin edhe të ndihmave që u duhet dhënë femrave migrante, shoqata e ka hartuar projektin në mënyrë të tillë që të ndihmojë kategorinë e migrantëve të brendshëm femra. Domosdoshmëria e kësaj përzgjedhjeje lind prej nivelit të lartë të papunësisë ndër gratë e Laknasit, që ka vështirësuar dhe mundësinë e integritit të tyre në komunitetin ku janë vendosur.

Kontakti i parë i tyre me shoqatën ka qenë nëpërmjet institucioneve shtetërore dhe vizitës të organizuar në Laknas. Rrjeti i shpërndarjes së informacionit mes të njohurish, duke aktivizuar dhe përfitues të shoqatës që banojnë në atë zonë, gjithashtu ka bërë efektin e vet. Gjatë intervistave disa nga gratë na thanë se ishin shoqet ose të njohurat e tyre, ato që i kishin informuar për punën që shoqata po bënte në komunitetin e tyre.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

Projekti sapo ka mbyllur një fazë të rëndësishme, ata të përfundimit të kurseve profesionale, ku profesionet më të përzgjedhura janë ato të rrobaqepëses dhe kuzhinieres, por mes tyre gjen edhe mësuese dhe ekonomiste të reja që kanë ndjekur kurse kompjuteri (e para) dhe gjuhe të huaj (e dyta). Rezultatet janë të dukshme. Gratë reflektojnë se kanë mësuar shumë nga këto trajnime, dhe së janë shumë entuziaste për mundësinë që u është dhënë. Për shkak se një pjesë e grave janë të martuara dhe me fëmijë dhe me situatë ekonomike familjare të dobët, projekti “Hidhe Hapin” ka ofruar një ndihmë të vogël ekonomike në formën e një pakete higjienike/ushqimore pas përfundimit me sukses të kursit.

Arritjet e kësaj faze të projektit do t’i numëronim kështu: grave iu dha një mundësi të dilnin nga shtëpia dhe të merrshin me diçka që nuk kishte të bënte vetëm me familjen e tyre, por me veten e tyre, saktësisht iu dha mundësia të mësojnë një profesion dhe të bëhen të afta e të dobishme për veten e tyre; profesioni do t’iu japë grave mundësinë të punësohen jashtë shtëpisë, duke u bërë të afta të konkurojnë në tregun e punës së zonës së tyre dhe kështu të sjellin të ardhura shtesë në shtëpi; grave iu dha mundësia të dalin jashtë dverve të shtëpisë dhe të njihen me gra të tjera të komunitetit të tyre, të shtojnë e forcojnë miqësi individuale e në grup, të njohin më mirë njëra-tjetrën dhe problemet e shqetësimet që i bashkojnë, të përpiqen të mbështesin e ndihmojnë njëra-tjetrën me iniciativa të pamenduara më parë; si edhe nëpërmjet aktiviteteve si seminarët mbi ruajtjen ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme apo raportet midis meshkujve dhe femrave në zonat rurale, ato arritën të njohin më mirë pozitën e tyre dhe të përpiqen ta përmirësojnë atë.

Arritjet e mësipërme u konfirmuan nga intervistat qoftë me vetë gratë përfituese, ashtu edhe me personelin e Shpresë për të Ardhmen, të cilët tashmë po përpiqen t’i ndihmojnë këto gra dhe vajza me fazën tjetër, atë të punësimit apo duke parë mundësinë e mbështetjes financiare për hapjen e një biznesi të vogël për disa prej tyre. Ndërkaq është krijuar mundësia për të punësuar një pjesë të grave dhe shpresohet për më shumë.

Puna e shoqatës në Laknas ka shkuar përtej trajnimit profesional dhe takimeve tematike. Futja në këtë komunitet ka rritur ndërgjegjësimin për fenomene të ndryshme shoqërore që ndikojnë negativisht në shoqërinë shqiptare. Fenomene si mbajtja e vajzave të reja në shtëpi dhe mos dërgimi i tyre në shkollë për shkak të mungesës së sigurisë dhe mendësisë patriarkale, që në këto komunitete ushqejnë njëra-tjetrën, mbeten serioze. Shoqata është përpjekur të vizitojë familje me probleme të tilla dhe të bisedojë me prindërit dhe me të rejat duke u përpjekur të vendosë një dialog midis palëve, në mënyrë që t’u jepet një mundësi këtyre vajzave të ndjekin shkollën apo thjesht të dalin nga muret e shtëpisë. Këto përpjekje janë ende në proces, kështu që vetëm në botime të mëvonshme do të mund të flasim për rezultatet e tyre.

Me të njëjtën frymë, shoqata në objektivat e veta ka theksuar se kërkon që integrimi dhe përmirësimi i kushteve të migrantëve të brendshëm të jenë afatgjata. Për këtë ata janë përpjekur së pari të tërheqin vëmendjen e autoriteteve vendore dhe përfshirjen e tyre në iniciativë duke synuar vazhdimësinë e objektivit të integritit të grave në komunitetet e formuara apo zgjeruara nga migrimi i brendshëm siç është Laknasi, edhe kur shoqata të mos operojë më në zonë, duke vendosur kështu një traditë bashkëkohore për trajtimin e drejtë të të gjitha grupeve shoqërore në komunitetet shqiptare.

5.5 Arritjet

Shpresë për të Ardhmen ka qenë një shoqatë me një aktivitet në rritje të vazhdueshme. Ajo ishte e para që trajtoi çështjen e riintegritit të të kthyerve me forcë dhe atyre vullnetarë në Shqipëri. Ajo gjithashtu është nga të parat që nuk është mjaftuar me riintegrimin ekonomik, por ka organizuar aktivitete shoqërore, të cilat kanë pasur si synim edhe lehtësimin social të përshtatjes sociale të të kthyerve.

Që nga fillimi i punës në nëntor 1999 e deri më sot në dyert e shoqatës kanë ardhur me qindra persona. Vetëm në projektin “Kape të Ardhmen” numërohen 901 meshkuj dhe 136 femra për një total prej 1037 aplikuesish. Ndarë në vite ato janë:

Tabela 1 Numri i aplikuesve ndarë sipas gjinisë së tyre.

Viti	Meshkuj	Femra	Totali
Viti 1999*	47	2	49
Viti 2000	173	12	185
Viti 2001	233	25	258
Viti 2002	152	4	156
Viti 2003	99	6	105
Viti 2004	84	42	126
Viti 2005	70	23	93
Viti 2006**	43	22	65

*Viti 1999 përfshin vetëm muajt nëntor-dhjetor.

** Viti 2006 përfshin vetëm periudhën janar-qershor.

Të gjithë këtyre personave u është ofruar shërbimi i parë i konsultimit me punonjësen sociale dhe, pasi kanë paraqitur dokumentet, rastet e tyre janë shqyrtuar një për një. Më pas stafi i ka marrë vendimin se cilët prej tyre do të përfitojnë nga shërbimet e mëtejshme të shoqatës, prej cilave shërbime do të përfitojnë ata dhe vetëm pastaj janë firmosur kontrata me pjesën më të madhe prej tyre. Themi pjesën më të madhe, pasi jo të gjithë vizitorët kanë qenë kontigjent për shoqatën dhe misionin e saj.

"SHPRESË PËR TË ARDHMEN"

Kështu, një vështrim i listave të kontratave të lidhura mes Shpresë për të Ardhmen dhe të kthyerit, vëmë re se ka pasur 56 kontrata të përfunduara gjatë vitit 2000, ndërkohë që 54 kontrata që kanë nisur në vitin 2000 janë përfunduar në 2001, dhe vetëm 5 prej tyre u ndërprejnë. Në 2001 u përfunduan gjithsej 99 kontrata, 83 të tjera vazhduan dhe përfunduan në 2002 dhe 5 u ndërprejnë. Në 2002 kemi numrin më të madh të kontratave të përfunduara, 113 dhe 77 të tjera të nisura në këtë vit përfunduan në 2003 dhe 11 të tjera u ndërprejnë. Në 2003 u përfunduan 105 kontrata ndërkohë që 47 vazhduan dhe përfunduan gjatë 2004, dhe 8 të tjera nuk u përfunduan. Numri i kontratave në 2004 ishte 164, prej të cilave 78 u përfunduan, 77 përfunduan një vit më pas dhe 9 u lanë në mes. Nga 146 kontratat e 2005, u përfunduan 93, gjatë 2006 kanë 41 prej tyre dhe janë ndërprerë 12. Të dhënat në këtë rast janë përlogaritur duke pasur parasysh se një pjesë e përfituesve e kanë filluar kontratën në vitin e parë dhe vazhduar në atë pasues. Kjo do të thotë se totali i përfituesve duhet të nxirret nga shuma e atyre që kanë përfunduar kontratat e mësimit të profesionit çdo vit, e njëjta gjë për kurset e trajnimit apo për kontratat e studentëve. Tabela më poshtë bën një pasqyrim më të plotë:

1999-2000	2001	2002	2003	2004	2005	Qershor 2006	
Kontrata të Përfunduara këtë vit	56	99	113	105	78	93	28
Kontrata të nisura këtë vit e të përfunduara në vitin pasues	54	83	77	47	77	41	
Kontrata të Ndërprera	5	5	11	8	9	12	
Totali	115	187	201	160	164	146	83*

*Gjatë 2006 kanë përfunduar vetëm 28 kontrata, ndërkohë që pjesa tjetër është në vijim duke qenë se viti nuk ka përfunduar.

Nga Tabela më lart del se gjatë periudhës 1999 deri në qershor 2006, shoqata ka pasur 572 kontrata të përfunduara dhe vetëm 50 të ndërprera me klientët e vet përfitues të projektit "Kape të Ardhmen" në programin e mësimit të profesionit. Shkaku kryesor i ndërprerjes ka qenë largimi i personave përsëri për në emigrim me ndonjë rast sporadik vdekjeje. Në përqindje do të thonim se klientët e shoqatës i kanë përfunduar kontratat në 91.96% të rasteve.

Gjithsesi, shifrat më lart reflektojnë vetëm kontratat e mësimit të profesionit. Nga paraqitja e aktiviteteve të shoqatës, ne dimë se ajo ka ofruar edhe kurse trajnimi, mbështetje financiare për studentët dhe ndihmë ekonomike. Përfituesit për çdo vit janë:

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Qershor 2006
Kurse	0	7	9	12	7	6	7	2
Studentë	0	5	2	4	2	6	6	7
Mësim Profesionit	20	95	133	116	70	91	70	32
Përfitues gjithsej	20	107	144	132	79	103	83	41

Nga 1999 deri në qershor 2006 shoqata ka mbështetur 50 persona që kanë ndjekur kurse të ndryshme kompjuteri, gjuhe të huaj apo patente. Nga ana tjetër janë mbështetur financiarisht 32 studentë duke i paguar atyre qoftë tarifën e shkollës, qoftë për nëntë muaj mbështetjen sipas modelit të mësimit të profesionit. Me projektin “Kape të Ardhmen” janë ndihmuar të mësojnë një profesion 627 persona që nga fillimi i projektit e deri në fund të qershorit 2006.

Përveç kategorive të mësipërme shoqata ka edhe përfitues të tjerë, të cilët kanë përfitur nga programet e ndihmës ekonomike, mbështetje për hapjen e një biznesi të vogël, si edhe përfitues nga projekte të tjera. Numri i përfituesve të papërfshirë më lart është paraqitur si më poshtë:

- 15 persona janë mbështetur për hapjen e një biznesi të vogël.
- 4 persona janë ndihmuar me blerjen e pajisjeve të punës.
- 112 persona kanë përfitur nga ndihma ekonomike.
- 74 persona kanë përfitur nga projekti VARRP të referuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin deri në gusht 2006.
- 11 persona kanë përfitur ng projekti HLWG.
- 21 persona kanë përfitur nga projekti ALNIMA referuar nga COOPI.
- 50 gra dhe vajza kanë përfitur nga projekti “Hidhe Hapin”.

Shoqata ka pasur ndër qëllimet e veta mbështetjen në veçanti të grave. Është vënë re se numri i femrave aplikuese ka qenë më i vogël se ai i meshkujve, kjo për shkak të faktit se gratë kanë emigruar më pak se burrat në vende si Zvicra e Gjermania dhe numri i të kthyerave forcërisht apo vullnetarisht ka qenë më i vogël se ai i burrave. Pavarësisht nga kjo, shoqata i ka angazhuar shumicën e aplikueseve në programet e veta, duke qenë së riintegrimi i femrave është më i vështirë se i meshkujve sepse shoqëria shqiptare është mjaft konservatore e tradicionale dhe kështu punësimi i tyre është më i vështirë. Faktor tjetër që ndikon negativisht në punësimin e femrave është edhe periudha e tranzicionit

"SHPRESË PËR TË ARDHMEN"

në Shqipëri, e cila ka ndikuar në rritjen e papunësisë në vend në përgjithësi, ku studjuesit kanë identifikuar si grupet më të prekura femrat dhe banorët e zonave rurale.

Përbërja e përfituesve e ndarë sipas gjinisë së tyre:

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Qershor 2006
Meshkuj	20	98	119	129	65	70	58	60
Femra	0	9	14	3	7	27	18	25
Totali i përfituesve	20	107	133	132	72	97	76	85

Shoqata është me qendër në Tiranë, por veprimtaria e saj është shtrirë në gjithë Shqipërinë. Në korrik 2006 shoqata hapi edhe degën e parë në rrethe në Shkodër. Përhapja e informacionit së bashku me dy pikat e kontaktit në Berat dhe Shkodër ka bërë që të ketë klientë nga Tirana, Shqipëria e Mesme, Veriu dhe Jugu i Shqipërisë. Edhe pse numri më i madh është nga Tirana, që është e kuptueshme, pasi Tirana është qyteti me popullsinë më të madhe në Shqipëri (rreth 800.000 banorë) dhe një pjesë e të kthyerve pavarësisht se kanë lindur në një anë tjetër të vendit, pas kthimit i kanë gjetur familjet e tyre të shpërngulura në Tiranë dhe kështu kanë qëndruar me ta në kryeqytet. Ka edhe të tjerë që janë vendosur përkohësisht në shtëpitë e të afërmeve të shpërngulur më parë, duke u përpjekur të gjejnë një punë, të fitojnë disa të ardhura dhe më pas të marrin një shtëpi me qira. Shpërndarja gjeografike e përfituesve:

	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Qershor 2006
Tiranë	15	49	59	42	17	52	38	38
Shqipëri e Mesme	2	5	8	1	3	2	5	4
Veri	2	22	26	22	22	17	15	30
Jug	1	31	40	67	30	26	18	12
Totali	20	107	133	132	72	97	76	85

Nga numri i përgjithshëm i përfituesve të përmendur më lart, shifrat tregojnë se çdo vit 60-84% e atyre që mbarojnë 9 muaj punë tek një punëdhënës, ndërkohë që shoqata pagan një pjesë të rrogës së tyre, kanë vazhduar të qëndrojnë në të njëjtin vend pune, këtë rradhë duke e marrë të tërë pagën nga punëdhënësi.

Tabela. Përqindja e klientëve që kanë vazhduar në të njëjtin profesion nga viti 2000 e deri në fund të 2005.

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Vazhdojnë në të njëjtin profesion pas përfundimit të kontratës	60%	80%	84%	81%	72.4%	72.5%

Tabela më lart tregon se numri më i ulët i klientëve që kanë vazhduar në të njëjtin profesion pas përfundimit të kontratës ka qenë në vitin 2000 me 60%, ndërkohë që numri më i madh është ai i vitit 2002 me 84% të klientëve. Vitet e fundit kjo përqindje ka qenë pak më shumë se 70% me një mesatare për gjashtë vitet e plota të punës së shoqatës (në vitin 1999 puna filloi në nëntor dhe viti 2006 është në vazhdim ndërsa shkruhet ky studim) prej 74.98%. Kjo shifër është shumë inkurajuese dhe flet për një punë pozitive nga ana e projektit Kape të Ardhmen në lidhje me riintegrimin ekonomik të të kthyerve që kanë qenë klientë të shoqatës.

Arritjet Individuale

Treguesi më i mirë i arritjeve të mëdha të shoqatës është fakti se mesatarisht 74.98% e klientëve vazhdojnë të punojnë tek i njëjti punëdhënës pas përfundimit të kontratës, duke treguar se këta njerëz kanë mësuar një profesion dhe janë bërë individë të besueshëm për punëdhënësit e tyre, të cilët janë të gatshëm t'i mbajnë duke u dhënë dhe pjesën tjetër të rrogës.

Përveç kësaj, nga intervistat mund të përmendim një sërë arritjesh individuale të të kthyerve, të cilët me ndihmën e shoqatës dhe vullnetin e tyre të mirë kanë arritur jo vetëm të gjejnë dhe mbajnë një punë në Shqipëri, por kanë shkuar përtej kësaj duke u kthyer në specialistë në fushën e vet, duke u vetëpunësuar dhe duke hapur aktivitete individuale, të cilat janë të suksesshme dhe sot dhe vazhdojnë të përparojnë me kalimin e kohës. Në këtë shkrim do të donim të përmendim disa nga rastet më të suksesshme. Është e qartë se këta njerëz kanë ndihmuar vetëveten për të arritur atje ku janë, por që të gjithë nënvizojnë përfshirjen në projektet e Shpresë për të Ardhmen si kthesën më vendimtare të jetës së tyre prej të kthyerish. Ata ia kushtojnë këtë riintegrim më të lehtë e të suksesshëm projektit që i angazhoi në punë dhe iu dha një arsye për t'u përpjekur për të ecur përpara. Më poshtë keni historitë e disa prej tyre.

Hashimi nga Tirana sot është 43 vjeç. Ai u kthye në Shqipëri në 2003 nga Italia dhe u pranua në projektin e ALNIMA-s për gjashtë muaj. Më pas, në kuadrin e nxitjes së biznesit të vogël, shoqata e ndihmoi me blerjen e një makine qepëse për të hapur një rrobaqepësi të vogël. Në atë periudhë, Hashimi ka marrë pjesë

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

në seminarët e organizuar në bashkëpunim me PSHM për biznesin e vogël. Sot, rrobaqepësia është një biznes i vogël i konsoliduar dhe Hashimi me të shoqën punojnë me kohë të plotë duke e kthyer atë në të vetmin burim të ardhurash për familjen e tyre. Ata shprehen se janë shumë të kënaqur me atë që kanë arritur dhe për këtë falenderojnë shoqatën, e cila u gjend pranë tyre në momentin kyç të kthimit, kur çdo gjë dukej e pashpresë dhe e vështirë për t’u kapërcyer.

Një rast tjetër që vlen të përmendet është ai i Hektorit 21 vjeçar, i cili u kthye nga Zvicra në 2001 sepse nuk kishte lejeqëndrim. Përfshirja në “Kape të Ardhmen” i dha mundësinë të mësonte profesionin e gdhendësit të drurit. Talenti dhe përkushtimi i tij bënë që shoqata t’i dhuronte makinerinë kryesore për gdhendjen e drurit, të cilën ai nuk mund ta përballonte dot me të ardhurat e veta, por që i dha mundësinë të punonte pas përfundimit të kontratës me Shpresë për të Ardhmen. Sot ai është një nga drupunuesit më të talentuar të Beratit dhe për këtë mjafton të shihet logoja e shoqatës, që mban firmën e tij.

Rasti i Bledit nga Shkodra është gjithashtu një sukses. Ai u kthye në Shqipëri në 2000 pas një periudhe në burgjet e Zvicrës, ku kishte ndjekur një kurs kompjuterash. Kjo aftësi e ndihmoi të gjejë një punë në një firmë që shiste kompjutera, ku vazhdoi të punonte edhe një vit pas përfundimit të kontratës me shoqatën. Më pas, ai hapi një biznes të vogël, më konkretisht një qendër interneti, dhe sot pesë vjet më vonë Bledi është pronari i një dyqani që shet dhe riparon kompjutera, si edhe vazhdon të merret me internet kafenë, duke u cilësuar si një biznesmen i suksesshëm në Shkodër. Edhe ai e vlerëson shumë ndërhyrjen e shoqatës në jetën e tij, pasi i dha mundësinë të punonte në fushën e kompjuterave, të cilën ai e kishte piketuar si fitimprurëse që gjatë qëndrimit të vet në Zvicër.

Zdrukthtaria “Kape të Ardhmen” që u hap në 2001 është një nga iniciativat e shoqatës Shpresë për të Ardhmen që synonte sipërmarrjen private të të rinjve që ishin klientë të saj. Shoqata në tërësi ka mbështetur 13 të rinj të hapin biznese të vogla, por vetëm zdrukthtaria ka mbijetuar si iniciativë dhe vazhdon të funksionojë si e tillë. Ajo u ideua nga pesë të rinj, të cilët kishin qenë klientë të projektit “Kape të Ardhmen”, të cilët aplikuan për fondin financiar, që shoqata kishte vënë në dispozicion të këtyre iniciativave. Ata përfituan 7000\$ në formën e një huaje dhe 3000\$ të tjerë në formën e një granti. Shoqata nuk ka arritur t’i mbledhë përsëri paratë e veta, pasi të rinjtë nuk ishin në gjendje të paguanin, por fakti që zdrukthtaria ka vazhduar të ekzistojë dhe është ende në zotërimin e ish-klientëve të shoqatës konsiderohet si një sukses, duke pasur parasysh kushtet e vështira si mungesa e energjisë gjatë gjithë kohës (në 2001 Shqipëria ka pasur shkurtime drastike të energjisë), me të cilat përballët biznesi i vogël në Shqipëri.

Nga grupi i të kthyerve vullnetarë mund të përmendim Adrianin nga Hamallaj që është kthyer nga Mbretëria e Bashkuar në 2004 dhe pas periudhës së kontratës me shoqatën, gjatë së cilës punoi si menaxher i një lokali në Sukth, vazhdoi të punonte atje edhe për rreth gjashtë muaj dhe muajin e fundit ka hapur një lokal bar-mezeri të vetën, të cilën ka marrë përsipër ta drejtojë e menaxhojë. Kjo iniciativë është ende shumë e re për t’u vlerësuar, por gjatë intervistës me të mësuam se gjatë periudhës disa javore që ka punuar në këtë iniciativë fitimet tashmë janë rritur dhe nëse ai do të arrijë të ruajë këto ritme do ta konsiderojë veten të suksesshëm.

Edlira është një tjetër histori e suksesshme. Ajo është kthyer vullnetarisht nga Gjermania në 2004 dhe është përfshirë në projektin “Kape të Ardhmen”. Nga ai përfitoi një kontratë 9 mujore, ku iu dha mundësia të punonte në një kompani që merret me botimin e hartave, atlaseve dhe gjërave të tjera të ngjashme. Atje ajo punoi me një rrogë minimale, dhe ndërkohë u ndihmua nga shoqata të ndiqte një kurs për të mësuar përdorimin e programit kompjuterik PhotoShop. Nëse para fillimit të punës, ishte ajo që i lutej punëdhënësit ta merrte në punë, gjatë atyre nëntë muajve aftësitë e saj u përmirësuar aq shumë, sa ishin ata që kërkuan që ajo të vazhdonte të punonte për ta si Art Designer duke i ofruar edhe një rrogë shumë të mirë. Edhe Edlira e vlerëson si shumë influencuese ndërhyrjen e shoqatës në riintegrimin e saj në Shqipëri.

5.6 Vështirësitë, shkaqet dhe kapërcimi i tyre

Puna në fushën e riintegritimit është një eksperiencë e re në Shqipëri, dhe siç është përmendur më lart, Shpresë për të Ardhmen është ndër të parët që janë marrë me riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe atyre të brendshëm. Duke qenë pionierë në këtë fushë, vështirësitë kanë qenë të llojeve të ndryshme, dhe punonjësit e shoqatës i kanë vëzhguar me qëllim që të gjenin shkaqet e tyre e kështu të mund t’i kapërcenin ato.

Një nga vështirësitë e para ka qenë përhapja e informacionit për ekzistencën e shoqatës dhe shërbimet që ofron ajo. Kjo është bërë fillimisht nga vetë donatorët dhe gjatë punës së vet shoqata ka arritur të kuptojnë se mediatizimi dhe publikimi i informacionit mbi shoqatën dhe shërbimet e saj duhej shtuar. Kjo është bërë nëpërmjet botimit të artikujve të ndryshëm në median zvicerane apo atë shqiptare në lidhje me punën e shoqatës, xhirimin dhe transmetimin e filmit dokumentar “Kape të Ardhmen”, botimin e buletinit të titulluar “Shpresë” dhe të përmbledhjes me historitë e emigrantëve “Në Udhëkryqet e Jetës”. Kohët e fundit shoqata ka ndërtuar dhe faqen e vet virtuale (www.shprese.org), ku të interesuarit mund të gjejnë informacion mbi punën e saj në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

Po kështu është vënë re se nuk është e lehtë të komunikosh dhe të punosh me kontigjentin e të kthyerve me forcë. Ata janë dyshues ndaj qëllimeve të njerëzve që përpiqen t’i ndihmojnë pa asnjë përfitim dhe hezitojnë të kërkojnë ndihmë. Vështirësia e parë e shoqatës ka qenë pikërisht fitimi i besimit të këtyre njerëzve, të cilët në fillim vinin një e nga një, dhe që sot tërheqin njëri-tjetrin. Ky skepticizëm që çonte në numrin e vogël të aplikuesve, psh në vitin 1999 pati vetëm 49 aplikantë nga të cilët 47 meshkuj dhe 2 femra, u pakësua me kalimin e kohës dhe gjatë 2000, shoqata pati 173 meshkuj dhe 12 femra të regjistruar dhe që kërkonin shërbimet e saj. Kjo u arrit nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore, sjelljes diskrete dhe miqësore të stafit me klientët, mbajtjen e premtimeve, respektimin e rregullave dhe gatishmërinë për t’i ndihmuar klientët sa më shumë që të jetë e mundur. Në të njëjtën kohë, shoqata ka shfrytëzuar vetë rrjetin e klientëve të vet për përhapjen e informacionit në lidhje me shërbimet e veta, dy prej tyre i ka punësuar si ndihmës së agjentit të rrjetit të punës, por edhe si pika kontakti për Beratën dhe Shkodrën, duke vënë në shërbim të të kthyerve njerëz me eksperiencë të ngjashme me ta, të cilët kanë shërbyer si garanci për seriozitetin dhe qëllimet e shoqatës.

Fakti që janë kthyer forcërisht në Shqipëri, si edhe thjesht ndryshimi i vendbanimit nga një vend evropian në një Shqipëri, e cila nuk është më ajo që ata kanë lënë, shkakton një tronditje të madhe psikologjike e emocionale tek një numër i konsiderueshëm të kthyerish. Çoroditja dhe vështirësitë në komunikim që ata kanë shfaqur kundrejt punonjësve të shoqatës, ka bërë që këta të fundit të identifikojnë nevojën e këshillimit psikologjik të klientëve. Për këtë arsye stafit të shoqatës i është shtuar dhe një psikologe, e cila do të merret me të gjitha rastet delikate, që kanë nevojë për këshillim psiko-social.

Duke qenë se komunikimi është vështirësuar edhe nga fakti se një pjesë e të kthyerve jetojnë në zonat periferike të vendit, nuk ka qenë e lehtë të kontaktosh me ta, apo që të përfshiheshin në projektet e shoqatës, pasi monitorimi ka qenë pothuaj i pamundur. Për këtë arsye shoqata ka menduar dhe realizuar hapjen e një zyre rajonale në Shkodër dhe ka punësuar një punonjëse sociale dhe një koordinator pune, të cilët mundësojnë ofrimin e shërbimeve për të gjithë zonën e veriut të Shqipërisë. Shkodra u përzgjedh pasi këto vitet e fundit shoqata ka pasur një numër në rritje aplikuesish nga Veriu, që e ka bërë këtë rajon prioritar për misionin e shoqatës.

Një vështirësi tjetër është fakti se të kthyerit me forcë në shumicën dërmuese i përkasin një grupi që ka qenë përfshirë me krimin dhe u ka sjellë fitime të mëdha. Kthimi në Shqipëri bëhet i vështirë për ta, pasi rrogat janë të ulta dhe mungon qëndrueshmëria në vendet e punës. Ndryshimi midis fitimeve atje dhe rrogës këtu është i madh, dhe shumë e kanë të vështirë të pranojnë një punë të tillë vetëm për të mbijetuar. Metoda e punës në këto raste ka qenë që

shoqata i ka lënë të lirë të vendosin, kanë zhvilluar një sërë seancash bisedash për t’i njohur klientët me tregun e punës në Shqipëri dhe me ofertën që përputhet me kualifikimet e tyre. Po kështu, u është lënë atyre të gjejnë vetë një punë sipas asaj që mendojnë më të përshtatshme për veten e tyre. Kjo u jep përshtypjen se janë ata që zgjedhin më të mirën për veten e tyre, gjë që e bën më të pranueshme dhe më jetëgjatë formën e ndihmës që ofron shoqata.

Në të njëjtën kohë, shoqata është përballur me raste mashtrimesh, ku persona të caktuar kanë pretenduar se janë emigrantë të kthyer për të përfutur mbështetjen ekonomike që ofron shoqata. Për të mos rënë më pre e këtyre formave të manipulimit, shoqata ka përpiluar një listë dokumentesh që u kërkohen aplikuesve për të vërtetuar se kanë qenë në një vend të huaj dhe janë kthyer që andej për një periudhë prej një viti. Verifikimi i këtyre dokumenteve dhe monitorimi i vazhdueshëm i punës së klientëve ka bërë që këto situata të shmangen përfundimisht.

Gjetja e punës është lloji tjetër i vështirësisë që ka pasur shoqata. Siç është përmendur më lart, shumica e klientëve vazhdojnë ta gjejnë vetë punën, pasi është vështirë të ndërmjetësosh në tregun e punës shqiptar, i cili është i karakterizuar nga bizneset e vogla e të mesme me bazë familjare dhe nga një natyrë informale e tyre. Kjo vështirësi nuk është kapërcyer ende, pasi përsa kohë tregu i punës mbetet joformal, vetë shoqata nuk mund t’i ndryshojë gjërat. Gjithsesi, kjo nuk i ka penguar të kërkojnë punë për klientët e tyre nëpërmjet njohjeve personale, reklamimit të vendeve të punës nëpër media, si psh. Çelsi, dhe së fundmi nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshje me Zyrat Rajonale të Punësimit në Tiranë dhe Shkodër, që mundësojnë referimin e klientëve të shoqatës në zyrën e punësimit dhe ndihmën e këtyre të fundit për gjetjen e një pune për ta në bazë të kualifikimeve që kanë dhe ofertave që kanë.

Përveç gjetjes së punës, e vështirë ka qenë dhe marrëdhënia me vetë punëdhënësit, të cilët ngurrojnë të bashkëpunojnë me shoqatën apo të firmosin kontrata formale me ta. Për të kapërcyer këto lloj problemesh, shoqata i fton punëdhënësit në zyrë për një bisedë sqaruese me ta, i ka vizituar ata në vendet e punës së bashku me klientin, si edhe ka organizuar takime “Shtëpi e Hapur”. Këto forma kanë dhënë rezultat deri në një farë mase. Kështu, bisedimet për kushtet e kontratës çojnë përherë në kapërcimin e pengesave dhe punësimit të klientëve të Shpresë për të Ardhmen, por takimet “Shtëpi e Hapur” nuk kanë qenë dhe aq frytdhënëse, pasi kërkesat e tyre si sigurimi i pajisjeve të punës apo dhënia e huave për zgjerim biznesi, nuk bëjnë pjesë tek objektivat dhe kompetencat e shoqatës.

Nga ana tjetër mbështetja për biznesin e vogël nga vetë klientët bën pjesë tek objektivat e shoqatës, por edhe kjo është një pikë e porealizuar ende. Ajo nuk

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

mund të ofrojë mbështetje financiare, pa realizuar përzgjedhjen e personave të kualifikuar për hapjen dhe mbajtjen e një biznesi të vogël e të mesëm, apo trajnimin e të interesuarve në këtë fushë. Gjithashtu, ata kanë ende nevojë të përkufizojnë masa sigurie që garantojnë kthimin e huasë pa shkaktuar humbje financiare, dhe çka është më e rëndësishme arritjen e suksesit me këto lloj iniciativash.

Komunikimi me institucionet shtetërore dhe marrja e mbështetjes së tyre ka gjithashtu rëndësinë e vet. Shoqata mendon se me rritjen e aktivitetit dhe reputacionit të saj u krijuan më shumë mundësi për bashkëpunim me institucionet shtetërore. Për këtë ka ndihmuar edhe IOM me projektet e veta ku përfshihen institucione qeveritare dhe organizata fitimprurëse dhe ku palët mund të takohen dhe marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta. Por duhet pranuar se vendosja e urave të komunikimit mes palëve nuk është e lehtë. Shoqata ka arritur të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale të Punësimit në Tiranë e Shkodër dhe me Bashkinë e Shkodrës. Këto marrëveshje kanë dhënë rezultate pozitive, mbasi shoqata ka mundur të dërgojë përfituesit e vet të trajnohen në qendrat shtetërore të formimit profesional, që janë të mira dhe me tarifa të ulëta, të marrin ofertat e punës dhe të regjistrojnë të papunët në listat e tyre etj. Në të njëjtën kohë, institucionet u kanë referuar raste të kthyerish nga emigracioni në mënyrë që të përfshihen në programet e Shpresë për të Ardhmen.

6. Përfundimet, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet

Ky studim u bë me qëllim që të bëhej një vlerësim i punës së shoqatës deri më sot, të përshfaqej kontributi i saj në fushën e riintegrit, të identifikohesh veçantia e eksperiencës së saj. Kjo të çon në nxjerrjen e mësimave dhe sugjerimin e disa rekomandimeve të përgjithshme dhe specifike, në mënyrë që jo vetëm shoqata të përfitojë për përmirësimin e shërbimeve të veta, por edhe i gjithë komuniteti i donatorëve, përfituesve, politikëbërësve dhe akademikëve të mund të përfitojnë prej tyre.

6.1 Përfundimet

Shoqata Shpresë për të Ardhmen e nisi punën e saj me emigrantët e kthyer që në vitin 1999, ku asnjë aktor tjetër nuk merrej me të kthyerit forcërisht. Shtete të ndryshme evropiane i kthenin shqiptarët e parregullt, por shpesh i gjenin ata sërish në rrugët e Zvicrës, Gjermanisë, Italisë dhe vendeve të tjera të Evropës. Rikthimi i pambështetur me masa riintegrimi nuk e pakësonte emigrimin e parregullt dhe kriminalitetin që e shoqëron.

Shpresë për të Ardhmen ka punuar me grupet e të kthyerve forcërisht, vullnetarë, si edhe migrantët e brendshëm, të cilët i ka mbështetur nëpërmjet projekteve si “Kape të Ardhmen”, VARRP, “Hidhe Hapin”, etj. Ata janë përfshirë në programe riintegrimi ekonomik, si kurset e formimit profesional, mësimi i një profesioni pranë një punëdhënësi për një periudhë nëntë muajsh ndërsa shoqata subvenciononte pagën e tyre, seminarët për hapjen e një biznesi, dhe

“SHPRESË PËR TË ARDHMEN”

plot aktivitete të tjera. Në të njëjtën kohë janë organizuar dhe aktivitete sociale, të cilat kanë synuar përballjen me problemet sociale që kanë të kthyerit dhe trajtimin e tyre, në mënyrë që të lehtësohej kthimi i tyre dhe në aspektin psiko-social. Aktiviteti i shoqatës është zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme dhe, që nga korriku ajo ka edhe një zyrë rajonale në Shkodër, krahas zyrës qendrore në Tiranë.

Me projektin “Kape të Ardhmen” shoqata numëron 901 meshkuj dhe 136 femra për një total prej 1037 aplikuesish, nga të cilët janë lidhur kontrata me 627. Numri i përfituesve nga projektet e tjera është 237. Klientët e “Kape të Ardhmen” i kanë përfunduar kontratat në 91.96% të rasteve. Këto shifra janë pozitive dhe vërtetojnë se sa e rëndësishme ka qenë mbështetja e shoqatës në jetën e këtyre njerëzve. Në intervistat e zhvilluara, ata theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit me shoqatën në periudhën e parë të kthimit në atdhe, si i vetmi aktor që ua ka lehtësuar riintegrimin ekonomik dhe social në vend, duke bërë që të mos mendojnë për të emigruar përsëri, por të ndërtojnë jetën e tyre në Shqipëri. Në fakt, një tregues tjetër i suksesit të shoqatës është edhe fakti se mesatarisht rreth 75% e klientëve kanë vazhduar të punojnë në të njëjtin vende edhe pas mbarimit të periudhës nëntëmuajore të subvencionimit nga ana e shoqatës. Një sërë personash jo vetëm që kanë mësuar një profesion, por edhe janë bërë specialistë në fushën e tyre dhe kanë ndërmarrë sipërmarrje të vogla private vetëm ose në bashkëpunim me njerëz të tjerë.

Përvoja disavjeçare me emigrantët e kthyer i ka siguruar një vend të respektuar në rrjetin e shoqatave që merren me migracionin, të cilat kanë bashkëpunuar vazhdimisht me Shpresë për të Ardhmen si në rastin e fundit të hartimit të dokumentit politik për riintegrimin e emigrantëve të kthyer në kuadrin e marrëveshjes së ripranimit midis Shqipërisë dhe BE-së të drejtuar nga IOM Tirana. Në të njëjtën kohë shoqata ka rritur bashkëpunimin me institucionet shtetërore duke firmosur marrëveshje bashkëpunimi me zyrat rajonale të punësimit Tiranë dhe Shkodër.

Këto veprime tregojnë qartë se në funksion të objektivave të saj kryesore, shoqata përveç aktiviteteve konkrete të riintegrimit që ka kryer deri tani, pa kalon në një fazë edhe më të rëndësishme të veprimtarisë së vet siç është politikëbërja nëpërmjet angazhimit të saj në rrjetin e aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë që merren me migracionin, dhe me rikthimin në veçanti.

6.2 Mësimet e nxjerra

Eksperienca e shoqatës ka shërbyer për të nxjerrë një sërë mësimesh, ndër të cilat mund të përmendim:

- shoqata ka nevojë ta bëjë punën e vet publike në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të arrijë te grupet përfituese dhe palët e tjera të interesuara në procesin e riintegrit;
- ndërgjegjësimi i komunitetit në lidhje me emigrimin duhet gjithashtu të jetë i vazhdueshëm;
- periudha prej nëntë muajsh është minimale dhe e domosdoshme për arritjen e rezultateve në lidhje me mësimin e një profesioni;
- të nxitet ndjekja e kurseve të formimit profesional për personat që nuk kanë një profesion konkurues për tregun e punës në Shqipëri;
- duhet realizuar ndihma për mbështetjen e iniciativave si hapja e bizneseve të vogla, edhe pse kjo është përkohësisht e vështirë për t'u realizuar;
- suksesi i saj mund të arrihet nëpërmjet ofrimit të trajnimeve për hapjen dhe administrimin e një biznesi të vogël, si edhe vendosjen e masave garantuese për të mos rrezikuar humbjen e huasë;
- mbështetja emocionale e shpirtërore janë të domosdoshme për integrimin social; hapja e një qendre kulturore do të ishte shumë pozitive për përforsimin e këtij lloji shërbimi;
- kontigjenti i të kthyerve ka nevojë për këshillimin me psikologun;
- të kthyerit gjithashtu kanë nevojë për këshillim ligjor;
- duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme për afrimin e komunitetit të punëdhënësve në aktivitetet e shoqatës për të tërhequr vëmendjen e tyre ndaj fenomenit dhe për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në procesin e riintegrit të emigrantëve të kthyer;
- duhet të përforsohet dhe shtohet bashkëpunimi me shoqata të tjera ndërkombëtare dhe lokale që punojnë me riintegrimin apo me migracionin në përgjithësi për të bashkuar forcat dhe përforsuar rezultatet pozitive;
- duhet të përforsohet dhe shtohet bashkëpunimi me institucionet shtetërore për lehtësimin e procedurave dhe ofrimin e ndihmës efektive për një riintegrim të qëndrueshëm e të suksesshëm;
- mbështetja për migrantët e brendshëm duhet të ofrohet për personat me nevoja më imediate dhe që jetojnë në nivelin më të ulët të varfërisë;
- gratë vazhdojnë të mbeten grupi më në nevojë për mbështetje për riintegrim, prandaj atyre iu duhet dhënë përparësi në projektet e shoqatës.

6.3 Rekomandimet

Duke analizuar periudhën shtatëvjeçare të punës së shoqatës, por edhe nga intervistat me punonjësit e saj, si edhe me përfituesit lindën një sërë

rekomandimesh, të cilat do t'i paraqesim më poshtë, në mënyrë që të identifikohet se ku ka hapësirë për ndryshim e përmirësim në fushën e riintegritit ekonomik e social të migrantëve të kthyer dhe atyre të brendshëm.

Rekomandime për shërbimet e riintegritit ekonomik

- Informimi i përfituesve për ekzistencën e shoqatës dhe shërbimet që ofron ajo të bëhet që në vendet pritëse para se ata të kthehen në Shqipëri, në mënyrë që të dinë ku të drejtohen që në periudhën e parë pas kthimit. Qendrat e mbyllura ku mbahen emigrantët para se të kthehen në vendet e origjinës sipas marrëveshjeve të ripranimit midis të dyja vendeve, ambasadat apo konsullatat në vendet pritëse dhe zyrat e migracionit në vendet pritëse mund ta shpërndajnë këtë informacion nëpërmjet broshurave apo fletëpalosjeve.
- Fletëpalosje të shoqatës dhe shërbimeve të saj të shpërndahen në pikat kufitare të vendit.
- Periudha e mësimit të profesionit të jetë më e gjatë, periudha e sugjeruar: 12 muaj, pasi në këtë mënyrë klientët arrijnë të përvetësojnë më mirë profesionin e synuar dhe në të njëjtën kohë njihen me punëdhënësin aktual dhe me tregun e punës në përgjithësi për atë profesion.
- Fondet e ofruara të jenë më të mëdha, duke pasur parasysh edhe tregun e punës në Shqipëri.
- Të ofrohet ndihmë për një numër më të madh përfituesisht që kërkojnë të blejnë mjetet e punës çka do t'ua lehtësonte atyre vetëpunësimin.
- Të ofrohen shërbime si këshillimi për hapjen e një biznesi.
- Të ofrohen trajnime për hapjen dhe manaxhimin e një biznesi.
- Të ofrohet shërbimi i ndërmjetësimit për lehtësimin e kredive për hapjen e bizneseve të vogla dhe të mesme.
- Të ofrohen grante dhe kredi/hua për përfituesit qoftë pa interesa ose me një periudhë prej një ose dy vjetësh pritjeje para rikthimit të kësteve përkundrejt një garancie të kontrollueshme.
- Të bëhen përpjekje për afrimin e biznesit shqiptar në mbështetje të programeve të riintegritit.

Rekomandime për shërbimet e riintegritit shoqëror

- Të ofrohet këshillimi psikologjik duke qenë se të kthyerit qofshin me forcë, qofshin vullnetarë përballen me një ndryshim të beftë ambjenti, që iu shkakton probleme të natyrës psikologjike.
- Të ketë sa më shumë aktivitete sociale e kulturore ku të kthyerit dhe migrantët e brendshëm të dëfrenjë dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin.
- Të zhvillohen fushata sensibilizuese në lidhje me edukimin e grave sidomos në zonat joformale dhe ato rurale.

Rekomandime për personelin e Shpresë për të Ardhmen

- Të zhvillohen trajnime të vazhdueshme me personelin e shoqatës në mënyrë që të jenë në kontakt të vazhdueshëm me risitë që kanë të bëjnë me riintegrimin në plan ligjor, politikash dhe atë profesional.
- Me rritjen e punës duhet të rriten dhe kapacitetet njerëzore.
- Të përfshihen të rinjtë, në veçanti studentët në njohjen e mundësive për punësim, ose të punës në terren.

Rekomandime për Shpresë për të Ardhmen

- Shoqata duhet të investojë më shumë kohë e energji në njohjen publike të punës dhe kontributit të saj në fushën e riintegrit.
- Shoqata duhet të përhapet më shumë në periferi të vendit, për të arritur në ato zona larg Tiranës dhe qyteteve të mëdha, ku ka më pak mundësi punësimi dhe riintegrimi është më i vështirë.
- Shoqata duhet të bëjë çdo përpjekje për të gjetur mundësitë financiare për të ndihmuar sa më shumë njerëz.
- Shoqata duhet t’u japë mundësi emigrantëve të shprehen publikisht në lidhje me interesat e tyre.
- Shoqata duhet të përfshihet më tepër në proceset e lobimit për çështjet që kanë të bëjnë me emigrantët, veçanërisht ata të kthyer në vend.
- Shoqata duhet të marrë më shumë pjesë në bërjen e politikave migratore, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të kthyerit dhe riintegrimin e tyre në vend.

Rekomandime të përgjithshme

- Të bëhen lehtësime ligjore nga ana e ligjvënësve dhe institucioneve shtetërore për hapjen e bizneseve të vogla dhe të mesme nga ana e emigrantëve të kthyer.
- Të bëhen lehtësime nga ana e institucioneve shtetërore për kreditë e marra nga kontigjenti i të kthyerve.
- Të përforcohet pozicioni i shtetit në raportin midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në mënyrë që të përforcohet dhe të mbrohet pozita e punëmarrësit në Shqipëri nëpërmjet pagimit të sigurimeve shoqërore dhe atyre shëndetësore.

BIBLIOGRAFIA

- Barjaba, K.
2004 "Albanian Looking Beyond Borders", Migration Information Source online at: <http://www.migrationinformation.org>.
- Barjaba, K.
2003 Shqiptarët këta ikës të mëdhenj. Korbi, Tirana.
- BE
2004a Marrëveshje Midis Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian mbi Ripranimin e Personave Residentë pa autorizim, 2004 COM 139 final, Bruksel.
- Black and Gent
2005 Defining, Measuring and Influencing Sustainable Return. Development Research Centre on Migration, Globalisation & Poverty Briefing No. 3 July.
2004 Defining, Measuring and Influencing Sustainable Return: The Case of the Balkans. Working Paper T7. Sussex Centre for Migration Research. December.
- Coslovi, L. and Pipierno, F.
2005 Forced Return and Than? By Lorenzo Coslovi and Flavia Pipierno. Final research report produced for the ALNIMA project. Centro Studi di Politiche Internazionali, Italy.
- Coslovi, L (Centro Studi di Politiche Internazionali)
2003 The Migratory Process from Albania to Italy.
- De Soto, H., Gordon, P., Gedeshi, I. and Sinoimeri, Z.
2002 Poverty in Albania. A Qualitative Assessment. Washington DC: World Bank Technical Paper 520.
- Hulst, M., Laczko, F. and Barthel, J.
2004 Identification of Sustainable Approaches to Voluntary Return and Reintegration of Asylum Seekers and Persons with Temporary Protection Status: Albania, Romania, and Russia; ERF Study.
- INSTAT
2004 Migracioni në Shqipëri, Popullsia dhe numërimi i banesave 2001. Instituti i Statistikës, Tiranë.
- IOM
2005a Competing for Remittances. By Nicolaas de Zwager, Ilir Gedeshi, Etleva Germenji, Christos Nikas. Tirana.
2005b Guidë për Instrumentat e Zgjedhura Ligjore të BE-së mbi Migracionin. Vienna: IOM, gusht.
- Klekowski von Koppenfels, A.
2004 Profiling of irregular migrants and analysis of reintegration needs of potential returnees from Kosovo (Serbia and Montenegro), Albania and

FYROM in Belgium, Italy, The United Kingdom and Germany, Brussels: IOM.
King. R. and Vullnetari, J.

2003 Migration and Development in Albania. WP C5, Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, University of Sussex, gjithashtu në version online në adresën: http://www.migrationdrc.org/publications/working_papers/WP-C5.pdf.

Kule, D., Mancellari A., Papapanagos, H Qirici S., Sanfey, P.

2002 “The causes and consequences of Albanian emigration during transition: evidence from micro-data”. International Migration Review 36 (I) pp. 229-39.

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

2005 Të dhëna të hollësishme mbi tregun aktual të punës në Shqipëri, [Detailed data on the current labour market in Albania], Tiranë 31 Maj.

Misja, Valbona

1998 International emigration in Albania over transition period. Marin Barleti. Tirana

Qeveria Shqiptare dhe IOM

2005 Strategjia Kombëtare e Migracionin dhe Plani Kombëtar i Migracionit.

Qeveria Shqiptare

2003 Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Formimit Profesional

Shpresë për të Ardhmen

2006 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 10. Tiranë. Janar.

2005 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 9. Tiranë. Qershor.

2005 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 8. Tiranë. Janar.

2004 Shpresë. Buletin Special me Rastin e 5-vjetorit. Tiranë

2004 Në udhëkryqet e jetës, Histori emigrimi. Tiranë: Shpresë për të Ardhmen.

2004 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 6. Tiranë. Shkurt.

2003 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 5. Tiranë. Shtator.

2003 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 4. Tiranë. Shkurt.

2002 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 3. Tiranë. Korrik.

2001 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 2. Tiranë. Tetor.

2001 Shpresë. Botim i Shoqatës. Numër 1. Tiranë. Mars.

SHKP

2005 Studimi i Tregut të Punës për periudhën Janar – Prill 2005 dhe parashikimi i tij për periudhën Maj – Shtator 2005. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Tiranë.



Shtojcat

Shtojca 1. Masat specifike për emigrantët e kthyer përmban Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin:

Nr.	Masa	Aktiviteti	Kërkesa Paraprake	Institucioni Përgjegjës	Institucioni Zbatues	Afati
3	Vlerësimi i mundësive konkrete që ofron Strategjia për Punësimin dhe Formimin Profesional për emigrantët e kthyer.	<p>1. Kryerja e një raporti vlerësues mbi mundësitë e formimit profesional që ofrohen aktualisht për emigrantët e kthyer dhe mbi nevojat dhe mangësitë ekzistuese.</p> <p>2. Parashikimi i masave konkrete në Strategjinë për Punësim dhe Formim Profesional për rritjen e nivelit të punësimit në vend të të kthyerve.</p>	Përfundimi i raportit vlerësues.	MPCSSH	MPCSSH	2006 2007-2010
6	Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave që u drejtohen emigrantëve mbi kthimin vullnetar, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që u ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e emigrantëve me mbështetjen e organizatave kombëtare ose ndërkombëtare.	Botimi i pamfletëve që ofrojnë informacion për procedurat e kthimit në Shqipëri, shërbimet sociale për riintegrim që disponohen, etj.		MPCSSH	MPP (MB), MPJ, MPCSSH	2006 e në vazhdim.
8.	Zgjerimi i shërbimeve riintegruese në mënyrë që të garantohet kthim i përhershëm.	<p>1. Hartimi dhe zbatimi i programeve të përbashkëta të punësimit me bizneset private.</p> <p>2.2. Ofrimi i shërbimit të këshillimit për karrierën, hyrjen në punë dhe formimit profesional.</p>		MPCSSH	ShKP në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë Shqiptare dhe Agjensitë e Zhvillimit Rural.	2006 e në vazhdim.
9.	Ngritja e Kapaciteteve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrave të saj, lokale e rajonale.	Programe specifike për trajnimin lidhur me asistencën për të kthyerit.	Reference masa 40.	MPCSSH	SHKP	2006

Shtojca 2. Të dhënat e mbledhura nga Anketa me të Rinjtë e Shkollave të Mesme.**SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME**

	Nr	Moshë			Epiteti për emigracionin			Keni emigruar ndonjëherë?		N.q.s do t'iu jepej mundësia për emigrim	
		15	16	17	Pozitiv	Negativ	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po do ta bëja	Jo do nguroja
Femra	52	7	32	13	2	42	8	2	50	13	39
Meshkuj	38	4	23	11	7	30	1	4	34	18	20
Gjithsej	90	11	55	24	9	72	9	6	84	31	59
Perqindja	100	12.2	61.1	26.7	10	80	10	6.7	93.3	34.5	65.5

"SAMI FRASHERI"

Mendoni se familja juaj do t'ju mbështeste?		Midis dy alternativave cila do ishte zgjidhja juaj?		Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqip. Do jetë i lidhur me emig.	
Po	Jo	Emig. në vend të huaj	Arsimimi në Shqipëri	Rritja e niv.ekon në vend.	Lufta ndaj emig. ilegal.	Liberalizimi I pol. të emig.	Po	JO
13	39	5	47	47	3	2	36	16
11	27	5	33	34	2	2	28	10
24	66	10	80	81	5	4	64	26
26.7	73.3	11.1	88.9	90	5.5	4.5	71.2	28.8

	SHTETI I PREFERUAR					
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	FRANCE	SH.B.A	SHTET TJETER
FEMRA	13	9	17	2	8	3
MESHKUJ	8	5	12	0	9	4
GJITHSEJ	21	14	29	2	17	7
PERQINDJA	23.3	15.5	32.2	2.3	18.9	7.8

SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME

	Nr	Mosha			Epiteti për emigracionin			Keni emigruar ndonjëherë?		N.q.s do t'iu jepej mundësia për emigrim	
		16	17	18	Pozitiv	Negativ	Poz. & Neg.	PO	JO	Po do ta bëja	Jo do nguroja
Femra	67	17	24	26	17	43	7	7	60	44	23
Meshkuj	33	7	16	10	14	17	2	12	21	21	12
Gjithsej	100	24	40	36	31	60	9	19	81	65	35
Përqindja	100	24	40	36	31	60	9	19	81	65	35

"KRISTAQ CAPO"

Mendoni se familja juaj do t'ju mbështeste?		Midis dy alternativave cila do ishte zgjidhja juaj?		Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqipërisë do jetë i lidhur me emigracionin?	
PO	JO	Emig. në vend të huaj	Arsimi në Shqipëri	Rritja e niv.ekon në vend.	Lufta ndaj emig. ilegal.	Liberalizimi i pol. të emig.	PO	JO
42	25	16	51	62	3	2	49	18
12	21	4	29	29	2	2	22	11
54	46	20	80	91	5	4	71	29
54	46	20	80	91	5	4	71	29

	SHTETI I PREFERUAR					
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	ZVICER	SH.B.A	SHTET TJETER
FEMRA	24	6	18	2	8	9
MESHKUJ	10	3	6	9	3	2
GJITHSEJ	34	9	24	11	11	11
PERQINDJA	34	9	24	11	11	11

SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME

	Nr.	Moshë			Epiteti më i përshtatshëm për emigracionin			Keni emigruar ndonjëherë?		N.q.s do t'iu jepej mundësia për emigrim	
		15	16	17	Pozitiv	Negativ	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po do ta bëja	Jo do ngurrroja
Femra	46	29	16	1	9	33	4	2	44	16	30
Meshkuj	24	10	10	4	10	13	1	5	19	15	9
Gjithsej	70	39	26	5	19	46	5	7	63	31	39
Përqindja	100	56	37	7	27	66	7	10	90	44	56

"BABË DUDË KARBUNARA"

Mendoni se familja juaj do t'ju mbështeste?		Midis dy alternativave të dhëna cila do të ishte zgjidhja juaj?		Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqipërisë do jetë i lidhur me emigracionin?	
Po	Jo	Emigracioni në vend të huaj	Arsimi në Shqipëri	Rritja e niv.ekon në vend.	Lufta ndaj emigr. ilegal.	Liberalizimi i politikave të emig.	Po	JO
16	30	3	43	38	7	1	22	24
9	15	5	19	22	1	1	13	11
25	45	8	62	60	8	2	35	35
36	64	11.5	88.5	87	11	2	50	50

	SHTETI I PREFERUAR					
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	ZVICER	SH.B.A	SHTET TJETER
FEMRA	13	3	16	3	7	4
MESHKUJ	9	2	7	2	2	2
GJITHSEJ	22	5	23	5	9	6
PERQINDJA	31.5	7.1	33	7.1	12.8	8.5

LICEU ARTISTIK

	Nr.	Moshë				Epiteti më i përshtatshëm për emigracionin			Kenë emigruar ndonjëherë?		N.q.se do t'iu jepej mundësia për emigrim	
		15	16	17	18	Poz.	Neg.	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po, do ta bëja	Jo, do ngurroja
F	16	3	6	5	2	3	9	4	0	16	5	11
M	12	2	7	3	0	8	4	0	3	9	8	4
Σ	28	5	13	8	2	11	13	4	3	25	13	15
%	100					39.28	46.42	14.28	10.71	89.28	46.42	53.58

"PRENKE JAKOVA" SHKODER

Mendoni se familja juaj do t'ju mbështeste?		Midis dy alternativave të dhëna cila do të ishte zgjidhja juaj?		Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqipërisë do jetë i lidhur me emigracionin?	
Po	Jo	Emigracioni në vend të huaj	Arsimi në Shqipëri	Rritja e niv.ekon në vend.	Lufta ndaj emigrac. ilegal.	Liberalizimi i politikave të emig.	Po	JO
8	8	1	15	14	1	1	8	6
6	6	5	7	9	2	1	5	5
14	14	6	22	23	3	2	13	11
50	50	21.42	78.58	82.14	10.71	7.14	46.42	39.28

P.S. Në lidhje me pyetjen "A mendoni se progresi i Shqipërisë në vitet në vijim do të jetë i lidhur ngushtë me emigracionin?" 4 prej nxënësve janë përgjigjur: këtë do ta tregojë koha.

	SHTETI I PREFERUAR					
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	ZVICËR	SH.B.A	SHTET TJETËR
FEMRA	5	0	4	0	1	6
MESHKUJ	5	2	2	1	0	2
GJITHSEJ	10	2	6	1	1	8
PERQINDJA	35.71	7.14	21.42	3.57	3.57	28.57

SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHME

	Nr	Mosha			Epiteti per emigracionin			Keni emigruar ndonjehere?		N.q.s do t,iu jepej mundesia per emigrim	
		17	18	19	Pozitiv	Negativ	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po do ta beja	Jo do ngru-roja
Femra	50				9	22	19	5	45	26	24
Meshkuj	15				9	3	3	2	13	9	6
Gjithsej	65				18	25	22	7	58	35	30
Perqindja	100				27.7	38.5	33.8	10.8	89.2	53.8	46.2

"PETRO NINI LUARASI"

Mendoni se familja juaj do t'ju mbeshteste?		Midis dy alternativave cila do ishte zgjidhja juaj?		Faktori me l rendesishem ne zvogelimin e emigracionit sipas mendimit tuaj eshte:			Progresi i Shqip. Do jete l lidhur me emig.	
Po	Jo	Emig. ne vend te huaj	Arsimi-mi ne Shqipe-ri	Rritja e niv.ekon ne vend.	Lufta ndaj emig. ilegal.	Libera-lizimi l pol. te emig.	Po	JO
29	19	15	35	46	3	1	40	8
6	8	1	14	13	2	0	10	5
35	27	16	49	59	5	1	50	13
53.9	41.5	24,6	75.4	90.8	7.7	1.5	76.9	20

P.S. Në lidhje me pyetjen "Mendoni se familja do t'ju mbështeste të emigronit?" 4,6 % prej nxënësve (2 femra dhe 1 mashkull) janë përgjigjur: prindërit do të ngurronin t'i lejonin të emigronin por as dhe nuk do t'i ndalonin nëse shkonin.

Ndërsa për pyetjen : "Progresi i Shqipërisë do të jetë i lidhur me emigracionin" 3,1 % (2 femra) janë përgjigjur as po as jo.

	SHTETI I PREFERUAR					SHTET TJETER
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	ZVICER	SH.B.A	
FEMRA	13	1	22	1	9	4
MESHKUJ	1	2	3	3	4	2
GJITHSEJ	14	3	25	4	13	6
PERQINDJA	21.5	4.6	38.5	6.2	20	9.2

TABELA

	Nr.	Epiteti për Migracioni			Keni emigruar ndonjëherë?		N.q.se do t'iu jepej mundësia për emigrim		Mendoni se familja juaj do t'ju mbështeste?	
		Poz.	Neg.	Poz. & Neg.	Po	Jo	Po, do ta bëja	Jo, do ngurrroja	Po	Jo
F	231	40	149	42	16	215	104	127	108	121
M	122	48	67	7	26	96	65	57	44	77
Σ	353	88	216	49	42	311	169	184	152	198
%	100	24.93	61.19	13.88	11.9	88.1	47.88	52.12	43.91	56.09

PËRMBLEDHËSE

Midis dy alternativave të dhëna cila do të ishte zgjidhja juaj?		Faktori më i rëndësishëm në zvogëlimin e emigracionit sipas mendimit tuaj është:			Progresi i Shqipërisë do jetë i lidhur me emigracionin?	
Emigracioni në vend të huaj	Arsimi-mi në Shqipëri	Rritja e niv.ekon në vend.	Lufta ndaj emigrac. ilegal.	Liberalizimi i politikave të emig.	Po	JO
40	191	207	17	7	155	72
20	102	107	9	6	78	40
60	293	314	26	13	233	111
17	83	88.95	7.37	3.68	68.56	31.44

P.S. 1 Në lidhje me pyetjen "A mendoni se progresi i Shqipërisë në vitet në vijim do të jetë i lidhur ngushtë me emigracionin?" 4 prej nxënësve janë përgjigjur: këtë do ta tregojë koha.

P.S. 2 Në lidhje me pyetjen "Mendoni se familja do t'iu mbështeste të emigronit?" 4,6 % prej nxënësve (2 femra dhe 1 mashkull) janë përgjigjur: prindërit do të ngurronin t'i lejonin të emigronin por as dhe nuk do t'i ndalonin nëse shkonin.

Ndërsa per pyetjen: "Progresi i Shqipërisë do të jetë i lidhur me emigracionin" 3,1 % (2 femra) janë përgjigjur as po as jo.

	SHTETI I PREFERUAR					
	ITALI	GJERMANI	ANGLI	ZVICËR	SH.B.A	SHTET TJETËR
FEMRA	68	19	77	6	33	28
MESHKUJ	33	14	30	15	18	12
GJITHSEJ	101	33	107	21	52	40
PËRQINDJA	28.53	9.32	30.22	5.93	14.69	11.30

***Kthimi nga Emigracioni
dhe Sfidat e Riintegrimit***